



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
[www.legjislacionishqiptar.gov.al](http://www.legjislacionishqiptar.gov.al)

**Nr.65**

**16 maj**

**2008**

## P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9905  
datë 24.4.2008

Për ratifikimin e “Marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Alpha Bank, A.E., National Bank of Greece, S.A., si rregullues dhe Alpha Bank, A.E., dega Londër, si agjent, për huanë 230 milionë euro për financimin e projektit të rrugës Rrëshen-Kalimash” ..... 2855

**LIGJ**  
**Nr.9905, datë 24.4.2008**

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË HUASË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, ALPHA BANK, A.E., NATIONAL BANK OF GREECE, S.A., SI RREGULLUES DHE ALPHA BANK, A.E., DEGA LONDËR, SI AGJENT, PËR HUANË 230 MILIONË EURO PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË RRUGËS RRËSHEN-KALIMASH”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Alpha Bank, A.E., National Bank of Greece, S.A., si rregullues dhe Alpha Bank, A.E., dega Londër, si agjent, për huanë 230 milionë euro për financimin e projektit të rrugës Rrëshen-Kalimash”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5701, datë 6.5.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**

Private & konfidenciale  
21 shkurt 2008 YIC/NALE/AT00675

Draft (4):

**MARRËVESHJE HUAJE**  
**PËR NJË PROJEKT HUAJE €230 000 000 €PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**  
**(PËRFAQËSUAR NGA KËSHILLI I MINISTRAVE,**  
**DUKE VEPRUAR NËPËRMJET MINISTRIT TË FINANCIVE)**

**DHËNË NGA**  
**BANKAT E PËRCAKTUARA NË GRAFIKUN 1**

**RREGULLUESIT**  
**ALPHA BANK A.E. DHE BANKA KOMBËTARE E GREQISË S.A.**  
**AGJENT**  
**ALPHA BANK A.E.**  
**DEGA E LONDRËS**

Kjo Marrëveshje e datës (-) dhe lidhur ndërmjet:

1. Republikës së Shqipërisë (përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, duke vepruar nëpërmjet Ministrit të tij të Financave), si Huamarrës;
2. Alpha Bank A.E. dhe Bankës Kombëtare të Greqisë S.A. si rregullues;
3. bankave, emrat dhe adresat e të cilave janë përcaktuar në grafikun 1; dhe
4. Alpha Bank A.E., dega e Londrës si Agjente, bihet dakord si më poshtë.

## 1. Qëllimi dhe përkufizimet

### 1.1 Qëllimi

Kjo Marrëveshje cakton termat dhe kushtet sipas dhe në bazë të të cilave bankat bien dakord, sipas detyrimeve të tyre të veçanta, t'i ofrojnë Huamarrësit një program huaje deri në dyqind e tridhjetë milionë euro (230 000 000 euro) për t'u përdorur me qëllim financimin e ndërtimit të seksionit Rrëshen – Kalimash të autostradës Durrës-Morinë në Shqipëri.

### 1.2 Përkufizimet

Në këtë Marrëveshje, nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe:

“Paradhënie” është çdo tërheqje e një pjese të shumës së përgjithshme nga Huamarrësi ose (siç mund ta kërkojë konteksti) shuma principale e kësaj huaje dhe “Paradhëniet” do të thotë një prej tyre ose të gjitha.

“Agjent” është Alpha Bank A.E., një shoqëri e themeluar në Republikën Greke, me zyrën e saj të regjistruar në rrugën: Stadiou 40, 102 52 Athinë, Greqi, që vepron për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje nëpërmjet degës së saj në Londër në rrugën: Cannon 66, Londër EC4N 6EP, Angli (ose në atë adresë tjetër që ajo mund t'u ketë njoftuar së fundi palëve të tjera në këtë Marrëveshje, në pajtim me klauzolën 17.1.3) ose një person tjetër që mund të caktohet si agjent nga bankat në pajtim me klauzolën 16.13 dhe përfshin pasuesit e tij në titull.

“Shqipëri” është territori i Republikës së Shqipërisë.

“Rregulluesit” janë, së bashku: a) Alpha Bank A.E., një shoqëri e themeluar në Republikën Greke, me zyrën e saj të regjistrimit në rrugën: Stadiou 40, 102 52 Athinë, Greqi; dhe b) Banka Kombëtare e Greqisë S.A., një shoqëri e themeluar në Republikën Greke, me zyrat e saj të regjistrimit në (-) (ose, në cilindo rast, me një adresë tjetër që mund t'u jetë njoftuar palëve të tjera në këtë Marrëveshje në pajtim me klauzolën 17.1.3) dhe përfshin pasuesit e tyre në titull dhe “Rregullues” është secili prej tyre.

“Ditë pune për bankat” është një ditë (përveç së shtunës dhe së dielës), në të cilën bankat janë të hapura për punë në Londër (Angli), Athinë (Greqi) dhe Tiranë (Shqipëri) dhe në lidhje me çdo datë për pagesa ose blerje në euro, çdo ditë TARGET.

“Banka” janë bankat e renditura në grafikun 1 dhe përfshin pasuesit e tyre përkatës në titull dhe zëvendësuesit dhe “Bankë” është secila prej tyre.

“Para të marra hua” është borxhi në lidhje me: i) paratë e marra hua ose të mbledhura dhe pasqyrat e debitit në banka; ii) çdo bono, letër, stok huaje, obligacion ose instrument i ngjashëm borxhi; iii) programe dokumentare ose pranimi të kredisë; iv) të arkëtueshmet e shitura ose të skontuara (të ndryshme nga ato me bazë moskthimi); v) pagesat e vonuara për sendet pasurore ose shërbimet e përfutuara; vi) qiratë financiare dhe kontratat e blerjeve me këste; vii) (përveç se në klauzolën 11.1.4), kontratat e prejardhura; viii) çdo veprim tjetër juridik (duke përfshirë pa kufizim marrëveshjet e shitjes ose blerjes paraprake) që ka efektin tregtar të huamarrjes ose mbledhjes së parave ose secila prej (ii) deri (vii) më sipër; dhe ix) garancitë në lidhje me borxhin e çdo personi brenda secilës prej (i) deri (viii) më sipër.

“Huamarrës” është Republika e Shqipërisë (përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, duke vepruar nëpërmjet Ministrisë të Financave).

“Këshilli i Ministrave” është Kryeministri, Zëvendëskryeministri dhe ministrat e Republikës së Shqipërisë të mbledhur si një organ i organizuar në pajtim me ligjin nr.9000, datë 13 janar 2003 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”.

“Shumë e dhënë” është, në lidhje me një bankë në një kohë të caktuar, shuma e caktuar në krah të emrit të saj në grafikun 1 dhe/ose, në rastin e zëvendësuesit, shuma e kaluar sipas përcaktimit në certifikatën e zëvendësimit, e pakësuar, në secilin rast, nga çdo term përkatës i kësaj Marrëveshjeje dhe kështu që, nëse në këtë moment shumat e përgjithshme të dhëna janë pakësuar në zero, referencat për te shuma e dhënë e një banke interpretohet si një referencë te shuma e dhënë e asaj banke menjëherë para pakësimit në zero dhe “shumat e dhëna” janë secila prej tyre dhe të gjitha së bashku.

“Kontribut” është, në lidhje me një bankë, shuma principale e huasë huajtur kësaj banke në një moment të caktuar.

“Kreditorët” janë, së bashku, rregulluesit, agjenti dhe bankat dhe “Kreditor” është secili prej tyre.

“Mospagimi” është çdo rast i mospagimit ose çdo rast ose rrethanë që, me dhënien e një njoftimi

nga agjenti dhe/ose kalimit të afatit përkatës dhe/ose përmbushja e një kushti tjetër (në secilin rast sipas parashikimit në klauzolën 11.1) do të përbënin një rast të mospagimit.

“Kontrata e prejardhur” është një kontratë, marrëveshje ose transaksion, që është:

a) shkëmbim i normës, shkëmbim bazë, shkëmbim i mallrave, veprim juridik paraprak për normën, opsioni i mallrave, shkëmbimi ose opsioni i kapitalit të vet (ose kapitali i vet ose indeks tjetër), opsion i bonove, opsioni i normës së interesit, veprim juridik me këmbimin valutor, kufizim, maksimal ose minimal, shkëmbim valute, opsion valute ose një veprim juridik tjetër i ngjashëm; dhe/ose

b) çdo kombinim i këtyre veprimeve juridike,

në çdo rast, qoftë me këmbim apo ndryshe.

“Data e tërheqjes” është, në lidhje me një paradhënie, data, duke qenë një ditë pune për bankat që futet në periudhën e tërheqjes, në të cilën tërhiqet ose duhet të tërhiqet një paradhënie.

“Njoftimi i tërheqjes” është, në lidhje me një paradhënie, një njoftim në formën ose thelbësisht në formën e grafikut 2, i mbushur rregullisht në lidhje me këtë paradhënie.

“Periudha e tërheqjes” është:

a) në lidhje me transhin A, periudha që fillon në datën e kësaj Marrëveshjeje dhe përfundon në datën e pushimit të fuqisë për transhin A;

b) në lidhje me transhin B, periudha që fillon në datën e pushimit të fuqisë për transhin A dhe përfundon në datën e pushimit të fuqisë për transhin B;

c) në lidhje me transhin C, periudha që fillon në datën e pushimit të fuqisë për transhin B dhe përfundon në datën e pushimit të fuqisë për transhin C;

ose, në çdo rast të tillë, përfundon në një nga datat e mëposhtme nëse është më parë:

i) data kur huaja është e barabartë me shumat e përgjithshme të caktuara; ose

ii) data kur Huamarrësi anulon të gjitha shumat e caktuara të patërhequra sipas klauzolës 6.6; ose

iii) data kur shumat e caktuara të përgjithshme pakësohen në zero në pajtim me klauzolat 6.3, 11.2 ose 13.1.

“Rëndim barësor” është çdo hipotekë, rëndim (qoftë fiks ose i ndryshueshëm), peng, e drejtë pengu, hipotekim, kalim nëpërmjet garancisë, marrëveshje besimi për qëllimin e dhënies së garancisë ose mjet tjetër sigurie të çdo lloji që garanton një detyrim të një personi ose një marrëveshje tjetër që ka efektin e dhënies së të drejtave të mbajtjes ose të kompensimit ose të drejta të tjera disponimi mbi një send pasuror (duke përfshirë pa kufizim transferimin e titullit dhe/ose marrëveshjet e mbajtjes që kanë efekt të ngjashëm) dhe përfshin çdo marrëveshje për të krijuar secilën nga të mësipërmet por nuk përfshin të drejtën e pengut që rrjedh nga ushtrimi i zakonshëm i tregtisë në bazë të ligjit dhe jo në bazë të kontratës.

“EURIBOR” është, në lidhje me një periudhë të caktuar:

a) norma zyrtare e aplikuar; ose

b) nëse nuk ka normë zyrtare për atë periudhë, kuptimi aritmetik i normave (të rrumbullakosura deri në katër pjesë dhjetore për lart) që i jepet agjentit me kërkesë të tij, të cituara nga bankat e referencës që është norma e ofruar nga bankat e referencës për bankat kryesore në tregun ndërbankar europian.

Në orën 11 00 a.m. (ora e Brukselit) në ditën e citimit për ofrimin e depozitave në euro për një periudhë të krahasueshme me atë periudhë.

“Euro”, “eurot” dhe “€” është monedha e vetme e Shteteve Anëtare Pjesëmarrëse dhe, në lidhje me të gjitha pagesat që bëhen sipas kësaj Marrëveshjeje në euro, janë fonde që ofrohen menjëherë dhe transferohen lirisht.

“Rasti i mospagimit” është një prej rasteve ose rrethanave të përshkruara në klauzolën 11.1.

“Borxhi i jashtëm” janë para të marra hua që: a) caktohet ose paguhet sipas opsionit të debitorit ose kreditorit në një monedhë të ndryshme nga leku shqiptar; ose b) i është marrë hua një personi që nuk është me vendbanim të përhershëm, ose zyra kryesore huadhënëse e të cilit ndodhet jashtë Republikës së Shqipërisë.

“Dokumente financimi” janë, së bashku, kjo Marrëveshje dhe çdo letër tarifash të përmendura në klauzolën 7.1 dhe “dokument financimi” është një prej tyre.

“Data e shlyerjes së parë” është data që është shtatëdhjetë e dy (72) muaj pas datës së kësaj Marrëveshjeje.

“Subjekt qeveritar” është një nënndarje politike, ekonomike ose administrative, ministri, departament, agjenci, autoritet publik, korporatë bordi ose ligjore e Huamarrësit (duke përfshirë, pa

kufizim, Bankën e Shqipërisë, dhe çdo shoqëri ose subjekt që kontrollohet drejtpërdrejt ose jodrejtpërdrejt nga Huamarrësi, ku për këtë qëllim “kontroll” do të thotë pronësi prej më shumë se pesëdhjetë për qind (50%) të kapitalit aksionar me të drejtë vote (ose të drejtën ekuivalente të pronësisë) të kësaj shoqërie ose subjekti ose kompetencë për të drejtuar politikën dhe menaxhimin e saj, nëpërmjet kontratës apo ndryshe.

“Borxh” është çdo detyrim për pagesën ose shlyerjen e parave qoftë si palë e drejtpërdrejtë, apo si dorëzanë, i tashëm apo i ardhshëm, faktik apo i mundshëm.

“Data për pagesën e interesit” është dita e fundit e një periudhe interesi.

“Periudhë interesi” është, në lidhje me një paradhënie ose hua, çdo periudhë për llogaritjen e interesit në lidhje me këtë paradhënie ose hua, e përcaktuar në pajtim me klauzolat 5.2 dhe 5.3.

“Hua” është shuma e përgjithshme principale që u është marrë hua bankave sipas kësaj Marrëveshjeje në një kohë të caktuar.

“Bankat e shumicës” janë në çdo kohë përkatëse bankat: a) shuma e kontributeve të të cilave e kalon gjashtëdhjetë e gjashtë pikë gjashtë për qind (66.6%) të huasë; ose b) (nëse nuk ka shuma principale të prapambetura sipas kësaj Marrëveshjeje) shuma e përgjithshme e shumave të dhëna prej të cilave e kalon gjashtëdhjetë e gjashtë pikë gjashtë për qind (66.6%) të shumave të përgjithshme të dhëna.

“Shpenzim i detyruar” është, në lidhje me një periudhë, një përqindje e llogaritur nga agjenti për këtë periudhë në një normë vjetore e përcaktuar nga zbatimi i formulës së treguar në grafikun 4.

“Marzh” është një pikë njëzet e pesë për qind (1.25%) në vit.

“Ministër i Punëve të Jashtme” është ministri, që është i autorizuar nga ligjet shqiptare për të sigluar autorizimin e Kryeministrit që autorizon Ministrin e Financave për të negociuar dhe pastaj autorizimin e Kryeministrit që autorizon Ministrin e Financave për të nënshkruar Marrëveshjen e Huasë para dërgimit përsëri në Këshillin e Ministrave.

“Muaj” ose “muajt” është periudha që fillon në një muaj kalendarik dhe përfundon në muajin përkatës pasues kalendarik në ditën që numerikisht përputhet me ditën e muajit kalendarik në të cilin ai filloi, me kusht që: i) nëse periudha ka filluar në ditën e fundit bankare në një muaj kalendarik ose nëse nuk ka ditë të tillë që të përputhet numerikisht, ajo përfundon në ditën e fundit bankare në këtë muaj pasues kalendarik; dhe (ii) nëse kjo ditë që përputhet numerikisht nuk është ditë bankare, periudha përfundon në ditën pasuese bankare në këtë muaj pasues kalendarik, por nëse nuk ka një ditë të tillë bankare, ajo përfundon në ditën pararendëse bankare dhe “muajore” interpretohet përkatësisht.

“Detyrimi neto i prejardhur” është, në çdo kohë, detyrimi neto (nëse ka) në këtë kohë i Huamarrësit dhe të gjithë subjekteve të tjera qeveritare të marrë si një e tërë në lidhje me kontratat e prejardhura të përcaktuara me anë të referencës tek shumat (siç përcaktohet nga agjenti) që do të ishte e pagueshme ose e arkëtueshme nga Huamarrësi dhe çdo subjekt tjetër qeveritar nëse kontratat e prejardhura, ku Huamarrësi dhe të gjithë subjektet e tjera qeveritare janë palë në këtë moment do të prisheshin në këtë moment dhe zëvendësoheshin nga detyrimi për të bërë një pagesë që reflekton barrën ose vlerën ekonomike për Huamarrësin ose subjektin përkatës qeveritar për fluksin e pagesave sipas atyre kontratave të prejardhura që mbetet në momentin e prishjes.

“Shtet Anëtar Pjesëmarrës” është çdo shtet anëtar i Bashkimit Europian, që fut ose ka futur euron si monedhë të ligjshme në pajtim me legjislacionin e Bashkimit Europian në lidhje me Bashkimin Ekonomik dhe Monetar.

“Datë kuotimi” është, në lidhje me një periudhë interesi ose periudhë tjetër për të cilën duhet të caktohet EURIBOR, data në të cilën kuotimet do të jepeshin zakonisht nga bankat kryesore në tregun ndërbankar europian për depozitat në euro për tu dorëzuar në ditën e parë të asaj periudhe interesi ose periudhe tjetër.

“Bankat e referencës” janë, në lidhje me EURIBOR dhe shpenzimin e detyruar, zyrtar kryesore në Londër të (Alpha Bank A.E., Banka Kombëtare e Greqisë S.A., dhe (-)) dhe/ose çdo bankë tjetër e caktuar si e tillë në pajtim me klauzolën 16.14.

“Datat e shlyerjes” janë, në pajtim me klauzolën 8.3, së bashku, data e parë e shlyerjes dhe secila prej datave që bien në intervale dymbëdhjetë (12)-muajore pas datës së parë të shlyerjes deri në dhe duke përfshirë datën që bie njëqind e tetëdhjetë (180) muaj pas datës së kësaj Marrëveshjeje.

“Norma zyrtare” është norma e përqindjes në vit e përcaktuar nga Federata Bankare e Bashkimit Europian për periudhën përkatëse, e treguar në faqen e duhur (duke qenë, në datën e kësaj Marrëveshjeje EURIBOR01) të Reuters. Nëse faqja e rënë dakord zëvendësohet ose shërbimi ndërpritet, Agjenti mund të përcaktojë një faqe ose shërbim tjetër që tregon normën përkatëse pas konsultimit me Huamarrësin dhe

bankat.

“Zëvendës” është kuptimi që i jepet në klauzolën 15.3.

“Certifikatë zëvendësimi” është certifikata thelbësisht në termat e grafikut 5.

“TARGET” është sistemi i pagesës Trans-European Automated Real-time Gross Settlement Express Transfer.

“Ditë TARGET” është çdo ditë ku TARGET është i hapur për kryerjen e pagesave në euro.

“Taksat” përfshijnë të gjitha taksat, tatimet, tarifatat, detyrimet për pagesë të tashme ose të ardhshme, të cilësdo natyrë dhe në cilindo juridiksion, duke përfshirë, pa kufizim, çdo taksë të vlerës së shtuar ose çdo kontribut ose detyrim që paguhet ose mbahet, së bashku me interesin e tyre dhe gjobat në lidhje me to dhe “tatim” interpretohet përkatësisht.

“Data e pushimit të fuqisë” është:

a) në lidhje me transhin A, 30 qershor 2008; ose

b) në lidhje me transhin B, 31 mars 2009,

ose në secilin prej këtyre rasteve, një datë e tillë e mëvonshme që Agjenti, në lirinë e tij absolute të vendimmarrjes, mund të bjerë dakord me shkrim.

“Shumat e përgjithshme të dhëna” janë në çdo kohë totali i shumave të dhëna e të gjitha bankave në këtë moment.

“Transhi A” është një transh i shumës të përgjithshme të dhënë deri në 130 000 000 euro që jepet ose (sipas kontekstit) duhet të jepet në pajtim me klauzolën 2.1.1 dhe dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje.

“Transhi B” është një transh i shumës së përgjithshme të dhënë që jepet ose (sipas kontekstit) duhet të jepet në pajtim me klauzolën 2.1.1, në atë shumë maksimale dhe ndryshe në atë mënyrë që përshkruhet në klauzolën 2.1.2(b) dhe dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje.

“Transhet” janë, së bashku, transhi A, transhi B, dhe “Transhet” janë secili prej tyre.

### 1.3 Titujt

Titujt e klauzolave dhe tabela e përmbajtjes janë futur vetëm për lehtësi reference dhe nuk merren parasysh në interpretimin e Marrëveshjes.

### 1.4 Interpretimi i termave të caktuara

Në këtë Marrëveshje, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe:

1.4.1 referencat në klauzolat dhe grafiqet duhet të interpretohen si referenca në klauzola dhe grafiqe në këtë Marrëveshje dhe referencat në këtë Marrëveshje përfshijnë grafiqet e saj;

1.4.2 referencat në këtë Marrëveshje (ose në një dispozitë të caktuar të saj) ose në një dokument tjetër interpretohen si referenca në këtë Marrëveshje, atë dispozitë ose atë dokument që është në fuqi për atë moment dhe që ndryshohet herë pas here në pajtim me termat e saj, ose sipas rastit, me marrëveshjen e palëve përkatëse dhe (nëse një pëlqim i tillë, sipas termave të kësaj Marrëveshjeje ose dokumentit përkatës, kërkohet të merret si kusht për këtë ndryshim që lejohet), pëlqimin paraprak me shkrim të Agjentit;

1.4.3 referencat në një “rregullore” përfshijnë çdo rregullore, rregull, direktivë, kërkesë, kërkim ose direktivë të tashme ose të ardhshme (pavarësisht nëse ka fuqinë e ligjit apo jo) të çdo agjencie, autoriteti, banke qendrore ose departamenti qeveritar ose çdo autoritet vetërregullator ose tjetër kombëtar apo mbikombëtar;

1.4.4 fjalët që janë në shumës përfshijnë edhe njëjës dhe anasjellas;

1.4.5 referencat për një orë të ditës janë sipas orës së Londrës;

1.4.6 referencat të një “person” interpretohen sikur përfshijnë referencat tek një individ, firmë, shoqëri, korporatë, grup të peregjistruar personash ose çdo Shtet ose secila prej agjencive të tij;

1.4.7 referencat të “sendet pasurore” përfshijnë të gjithën ose një pjesë të aktivitetit, ndërmarrjes, pronës së paluajtshme, pronës personale, kapitali i pacaktuar dhe çdo të drejtë (faktike ose të mundshme, të tashme ose të ardhshme) për të marrë ose kërkuar dorëzimin e një prej sa më sipër;

1.4.8 referencat të “garancia” përfshijnë referencat të një zhdëmtim ose garanci tjetër kundër humbjes financiare duke përfshirë, pa kufizim, një detyrim për të blerë sendet pasurore ose shërbimet si pasojë e një mospërmbushjeje nga çdo person tjetër për të paguar për çdo borxh dhe “i garantuar” interpretohet përkatësisht;

1.4.9 referencat tek “ekuivalenti” i një shume të përcaktuar në një monedhë të caktuar (shuma me monedhë të përcaktuar) interpretohet si një referencë tek shuma e monedhës tjetër përkatëse që mund të blihet me shumën e monedhës së përcaktuar në tregun e këmbimit të valutës në Londër në ose rreth

11.00 para dite në ditën në të cilën llogaritja duhet të bëhet për dorëzimin faktik sipas përcaktimit nga Agjenti; dhe

1.4.10 referencat për një akt ligjor mendohen të përfshijnë referencat për këtë akt të rimiruar, ndryshuar ose zgjeruar.

#### 1.5 Bankat e shumicës

Nëse kjo Marrëveshje parashikon që një çështje të përcaktohet nëpërmjet referimit të mendimi i bankave të shumicës ose t'i nënshtrohet pëlqimit ose kërkesës së bankave të shumicës ose që një veprim të ndërmerret sipas udhëzimeve të bankave të shumicës, ky mendim, pëlqim, kërkesë ose udhëzim (si ndërmjet bankave) konsiderohet sikur është dhënë ose nxjerrë në mënyrë të vlefshme nga bankat e shumicës nëse të gjitha bankat kanë marrë njoftim paraprak mbi çështjen për të cilën kërkohet të merret ky mendim, pëlqim, kërkesë ose udhëzim dhe shumica përkatëse e bankave e ka dhënë ose nxjerrë këtë mendim, pëlqim, kërkesë ose udhëzim, por në mënyrë të tillë që (si ndërmjet Huamarrësit dhe bankave) Huamarrësi ka të drejtën (dhe detyrimin) të prezumojë që ky njoftim është marrë rregullisht nga secila bankë dhe që është krijuar shumica përkatëse për të përbërë bankat e shumicës pavarësisht nëse kjo është faktikisht e vërtetë ose jo.

### 2. Programi

#### 2.1 Shuma

2.1.1 Bankat, duke u mbështetur në secilin prej përfaqësuesve dhe garancive të klauzolës 9, bien dakord t'i japin hua Huamarrësit me dhe sipas termave të kësaj Marrëveshjeje shumën principale deri në 230 000 000 euro në dy (2) transhe (dhe deri në dhjetë (10) paradhënie.

2.1.2 Bankat ofrojnë transhet si më poshtë:

a) shuma maksimale e tërhequr në transhin A nuk i kalon 130 000 000 euro;

b) shuma maksimale e tërhequr në transhin B nuk i kalon 100 000 000 euro, me kusht që një shumë e tillë rritet automatikisht në datën e ndërprerjes për transhin A me një shumë të barabartë me shumën e patërhequr dhe të paanuluar të transhit A (nëse ka) në këtë datë (dhe, për mënjanimin e dyshimit, palët bien dakord që në këtë datë çdo shumë e patërhequr dhe e paanuluar pushon së qeni e ofrueshme në transhin A dhe ofrohet në, dhe përbën pjesë të transhit B); dhe

2.1.3 Detyrimi i secilës bankë sipas kësaj Marrëveshjeje është të kontribuojë me atë raport të secilës paradhënie që, në datën e tërheqjes së kësaj paradhënieje, shuma e dhënë prej saj ka ndaj shumave të përgjithshme të dhëna.

#### 2.2 Detyrimet e veçanta

Detyrimet e secilës bankë sipas kësaj Marrëveshjeje janë të veçanta; mospërmbushja nga një bankë e këtyre detyrimeve nuk lirojnë asnjë kreditor ose Huamarrësin nga ndonjë prej detyrimeve përkatëse të tyre në bazë të kësaj Marrëveshjeje dhe as Agjenti apo rregulluesi nuk është përgjegjës për detyrimet e bankës (përveç detyrimeve të veta, nëse ka, si bankë) dhe asnjë bankë nuk është përgjegjëse për detyrimet e një banke tjetër sipas kësaj Marrëveshjeje.

#### 2.3 Interesat e veçantë

Pavarësisht nga termat e tjerë të kësaj Marrëveshjeje (por duke mos cenuar dispozitat e kësaj Marrëveshjeje në lidhje me kërkimin e veprimit nga bankat e shumicës), interesat e kreditorëve janë të veçanta dhe shuma që i paguhet Agjentit (për llogari të tij), rregulluesve dhe secilës bankë është një borxh i veçantë dhe i pavarur. Secili kreditor ka të drejtën të mbrojë dhe ekzekutojë të drejtat e tij që lindin nga kjo Marrëveshje dhe nuk është e nevojshme që një kreditor tjetër (sipas rastit) të përfshihet si palë shtesë në një nga gjykimet për këtë qëllim.

### 3. Kushtet

#### 3.1 Dokumentet dhe provat

Detyrimi i secilës bankë për të ofruar shumën e dhëna i nënshtrohet kushtit që Agjenti, ose përfaqësuesi i tij i autorizuar rregullisht, të ketë marrë, jo më vonë se dy (2) ditë bankare para ditës në të cilën jepet njoftimi i tërheqjes në lidhje me paradhënien e parë, dokumentet dhe provat e përcaktuara në grafikun 3 në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Agjentin.

#### 3.2 Precedenti i kushteve të përgjithshme

Detyrimi i secilës bankë për të kontribuar për çdo paradhënie u nënshtrohet kushteve të mëtejshme që në datën e secilin njoftim tërheqjeje dhe në secilën datë tërheqjeje:

3.2.1 përfaqësuesit dhe garancitë e caktuara në klauzolën 9.1 (dhe kështu që përfaqësimi dhe garancia e klauzolës 9.1.10 u referohen për këtë qëllim deklarimeve të fundit të dhëna Agjentit sipas klauzolës 10.1.5) janë të vërteta dhe të sakta në dhe për secilën datë sikur secila të ishte bërë në lidhje me

faktet dhe rrethanat që ekzistojnë në këtë datë; dhe

3.2.2 nuk ka ndodhur, nuk ka vazhduar ose nuk do të rezultonte asnjë mospërbushje nga dhënia e kësaj paradhënieje.

### 3.3. Heqja dorë nga precedentet e kushteve

Kushtet e përcaktuara në këtë klauzolë 3 janë futur vetëm në interes të bankave dhe mund të hiqet dorë prej tyre në emër të tyre plotësisht ose pjesërisht dhe me ose pa kushte nga Agjenti duke vepruar sipas udhëzimeve të bankave së shumicës në lidhje me paradhënien e parë dhe të tjera pa cenuar të drejtën e Agjentit që vepron në bazë të udhëzimeve të tilla për të kërkuar përmbushjen e këtyre kushteve plotësisht ose pjesërisht në lidhje me një paradhënie tjetër.

### 3.4 Precedenti i kushteve të tjera

Jo më vonë se pesë (5) ditë bankare para çdo date tërheqjeje dhe çdo date për pagesën e interesit, Agjenti mund të kërkojë dhe Huamarrësi, jo më vonë se dy (2) ditë bankare para kësaj date, i dorëzon Agjentit me këtë kërkesë certifikata të tjera të favorshme dhe/ose mendime në lidhje me një ose të gjitha çështjet që u nënshtrohen klauzolave 3.1, 9, 10 dhe 11.

### 3.5 Njoftimi

Agjenti njofton bankat menjëherë pas marrjes prej tij të dokumenteve dhe provave të përmendura në klauzolën 3.1 në formë dhe përmbajtje të pranueshme për të.

## 4. Paradhëniet

### 4.1 Tërheqja

Në pajtim me termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje një paradhënie i jepet Huamarrësit pas marrjes nga Agjenti prej Huamarrësit të një njoftimi tërheqjeje jo më vonë se ora 10 00 para dite në ditën e tretë bankare para datës së propozuar për tërheqjen. Një njoftim për tërheqjen hyn në fuqi në momentin e marrjes faktike prej Agjentit dhe, pas dhënies, në pajtim me parashikimin e klauzolës 5.7.1, është i përvokueshëm.

### 4.2 Shuma, afati dhe kufizimet e transeve dhe paradhëniet

4.2.1 Çdo paradhënie tërhiqet brenda një transhi dhe është minimalisht 5 000 000 euro ose një shumë të përgjithshme prej 5 000 000 euro ose balancën e shumave të dhëna në lidhje me këtë transh.

4.2.2 Çdo paradhënie përcaktohet në euro.

4.2.3 Asnjë paradhënie nuk tërhiqet brenda një transhi nëse, si rezultat i tërheqjes së këtij transhi, numri i përgjithshëm i paradhëniet të tërhequra brenda këtij transhi do të ishte më shumë se pesë (5).

4.2.4 Secila paradhënie përdoret përjashtimisht për qëllimet e përcaktuara në klauzolën 1.1.

### 4.3 Njoftimi për bankat

Menjëherë sa të jetë e mundur pas marrjes së një njoftimi tërheqjeje që përmbush termat e kësaj Marrëveshjeje, Agjenti njofton secilën bankë dhe, në pajtim me klauzolën 3, secila prej bankave në datën e tërheqjes i jep Agjentit pjesën e saj të paradhënies përkatëse në pajtim me klauzolën 8.2.

### 4.4 Ndërprerja e shumave të përgjithshme të dhëna

Çdo pjesë e shumave të përgjithshme të dhëna që nuk është tërhequr dhe nuk është anuluar deri në datën e ndërprerjes në lidhje me transhin B pas kësaj anulohet automatikisht.

### 4.5 Përdorimi i shumave

Pa cenuar detyrimet e Huamarrësit sipas klauzolës 10.1.3, asnjë nga kreditorët nuk ka ndonjë përgjegjësi për zbatimin e shumave të ndonjë paradhënieje nga Huamarrësi.

## 5. Interesi dhe periudhat e interesit; normat alternative të interesit

### 5.1 Norma nominale e interesit

Huamarrësi paguan interes për çdo paradhënie ose, sipas rastit, huanë në lidhje me çdo periudhë interesi në datën përkatëse të pagesës së interesit (ose, në rastin e periudhave të interesit prej më shumë se tre (3) muaj që mund të kenë hyrë në fuqi në pajtim me klauzolën 5.4 ose klauzolën 5.7.2, me këste, çdo tre (3) muaj nga fillimi i periudhës së interesit në datën përkatëse të pagesës së interesit) me normë vjetore të përcaktuar nga Agjenti që është shuma e: a) marzhi, b) shpenzimet e detyrueshme (nëse ka) dhe c) EURIBOR për këtë periudhë interesi.

### 5.2 Zgjedhja e periudhave të interesit

Secila Periudhë interesi ka një kohëzgjatje prej tre (3) muajsh.

### 5.3 Përcaktimi i periudhave të interesit

Secila periudhë interesi ka kohëzgjatjen e përcaktuar në klauzolën 5.2, por që:

5.3.1 Periudha fillestare e interesit në lidhje me çdo paradhënie fillon në datën përkatëse të tërheqjes dhe secila periudhë pasuese interesi në lidhje me këto paradhënie fillon me skadimin e periudhës pararendëse të interesit;

5.3.2 Periudha fillestare e interesit në lidhje me çdo paradhënie pas paradhënies së parë përfundon në të njëjtën ditë, si dhe periudha pasuese e interesit për paradhënien e mëparshme ose, sipas rastit, huanë dhe, në ditën e fundit të kësaj periudhe interesi, të gjitha paradhëniet e tërhequra bashkohen me, dhe pas kësaj përbëjnë huanë; dhe

5.3.3 nëse një periudhë interesi tejkalonte një datë të shlyerjes, në rastin e datës së fundit të shlyerjes, kjo periudhë interesi përfundon në këtë datë shlyerjeje dhe, në rastin e një date tjetër shlyerjeje, huaja ndahet në dy pjesë, një në një shumë jo më të vogël se kësti i shlyerjes i kërkueshëm në këtë datë shlyerjeje dhe që ka një periudhë interesi që përfundon në këtë datë dhe tjetra në një shumë të barabartë me balancën e huasë që ka një periudhë interesi të konstatuar në pajtim me klauzolën 5.2 dhe dispozitat e tjera të kësaj klauzole 5.3.

#### 5.4 Interesi për pagesën e vonuar

Nëse Huamarrësi nuk paguan një shumë (duke përfshirë, pa kufizim, një shumë të pagueshme në pajtim me këtë klauzolë 5.4) në datën e kërkueshme për pagesë sipas kësaj Marrëveshjeje, Huadhënësi paguan interes për këtë shumë nga data e kërkueshme deri në datën e pagesës faktike (si para ashtu edhe pas vendimit) me një normë interesi të përcaktuar nga Agjenti sipas klauzolës 5.4. Periudha që fillon në një datë të tillë të kërkueshme dhe që përfundon në këtë datë të pagesës ndahet në periudha pasuese prej jo më shumë se gjashtë (6) muajsh që zgjidhen nga Agjenti (pas konsultimit me bankat në masën që është praktikisht e arsyeshme sipas rrethanave) secila prej të cilave (përveç së parës, që fillon në datën e kërkueshme) fillon në datën e fundit të çdo periudhe pararendëse. Norma e interesit të zbatueshëm në secilën prej këtyre periudhave është shuma e (sipas përcaktimit nga Agjenti): a) dy për qind (2%) në vit, b) marzhit, c) shpenzimeve të detyrueshme dhe d) EURIBOR për këtë periudhë. Ky interes është i kërkueshëm dhe i pagueshëm në ditën e fundit të secilës prej këtyre periudhave sipas përcaktimit nga Agjenti dhe çdo ditë e tillë trajtohet për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje si datë e pagesës së interesit, përveç kur kjo shumë e papaguar është një shumë e shumës principale që është bërë e kërkueshme dhe e pagueshme nëpërmjet një deklarate nga Agjenti në bazë të klauzolës 11.2 ose një parapagimi në pajtim me klauzolat 6.3 ose 13.1, para datës pasuese për pagesën e interesit në lidhje me të, rast në të cilin periudha e parë e zgjedhur nga Agjenti përfundon në atë datë të pagesës së interesit dhe interesi është i pagueshëm mbi këtë shumë të papaguar gjatë kësaj periudhe me një normë prej dy për qind (2%) mbi normën e zbatueshme për të menjëherë para se ajo të bëhet e kërkueshme dhe e pagueshme. Interesi në bazë të kësaj klauzole 5.4 është i kërkueshëm dhe i pagueshëm në ditën e fundit të secilës periudhe të përcaktuar nga Agjenti në pajtim me këtë klauzolë 5.4 ose, nëse bëhet më parë, në datën në të cilën shuma për të cilën po mblidhet interesi faktikisht paguhet. Nëse, për arsytet e përcaktuara në klauzolën 5.7.1(a) ose 5.7.1(b), Agjenti nuk është në gjendje të caktojë një normë interesi në pajtim me dispozitat e mësipërme të kësaj klauzole 5.4, secila Bankë njofton menjëherë Agjentin për shpenzimet e fondeve për këto banka dhe interesi për çdo shumë të papaguar deri në datën e kërkueshme të pagesës llogaritet për secilën bankë me një normë të përcaktuar nga Agjenti të jetë dy për qind (2%) në vit mbi shumën e marzhit dhe shpenzimeve të fondeve (duke përfshirë shpenzimet e detyrueshme (nëse ka)) për këtë bankë.

#### 5.5 Njoftimi i periudhave të interesit dhe normës së interesit

Agjenti njofton Huamarrësin dhe bankat menjëherë për kohëzgjatjen e periudhave të interesit ose periudhave të tjera për llogaritjen e interesit (ose, sipas rastit, interesin e vonuar) dhe për çdo normë interesi të caktuar prej tiji sipas kësaj klauzole 5).

#### 5.6 Kuotimet e bankës së referencës

Nëse një bankë reference nuk është në gjendje apo nuk jep një kuotim për qëllimin e llogaritjes së EURIBOR-it (nëse një kuotim i tillë kërkohet duke pasur parasysh përkufizimin e klauzolës 1.2 të EURIBOR-it) norma e interesit për periudhat përkatëse të interesit përcaktohet, në bazë të klauzolës 5.7, mbi bazën e kuotimeve të dhëna nga bankat e tjera të referencës.

#### 5.7 Prishja e tregut; mosdisponibiliteti

##### 5.7.1 Nëse dhe kurdoherë që në një moment para fillimit të një periudhe interesi:

a) (në një moment kur kërkohen kuotimet e bankës së referencës, duke pasur parasysh përkufizimin e klauzolës 1.2 të EURIBOR-it), Agjenti ka konstatuar, pas konsultimeve me bankat e referencës (konstatim i cili, në mungesë të gabimeve të dukshme, është përfundimtar), që nuk ekzistojnë

mjete të përshtatshme dhe të drejta për të konstatuar EURIBOR-in gjatë kësaj periudhe interesi; ose

b) asnjë ose vetëm një nga bankat, e referencës i jep Agjentit një kuotim për qëllimin e llogaritjes së EURIBOR-it për këtë periudhë interesi (nëse një kuotim i tillë kërkohet në lidhje me përkufizimin e klauzolës 1.2 të EURIBOR-it); ose

c) Agjenti ka marrë njoftim nga bankat, kontributet e të cilave japin një shumë jo më të vogël se një të tretat (1/3) e huasë (ose, para datës së parë të tërheqjes, shumat e dhëna mbledhen në një shumë jo më të vogël se një të tretat (1/3) të shumave të përgjithshme të dhëna) që depozitat në euro nuk janë të disponueshme në këto banka në tregun ndërbankar evropian në vazhden normale të aktivitetit në shumat të mjaftueshme për fondet e kontributeve të tyre për këtë periudhë interesi ose që EURIBOR nuk reflekton saktësisht koston e këtyre bankave për përfundimin e këtyre depozitave,

Agjenti i bën menjëherë një njoftim (njoftim përcaktimi) Huamarrësit dhe secilës prej bankave. Një njoftim përcaktimi përmban hollësitë e rrethanave përkatëse që mbështesin nxjerrjen e tij. Pas dhënies së njoftimit të përcaktimit shumat e patërhequr e shumave të përgjithshme të dhëna nuk tërhiqen derisa Huamarrësit t'i bëhet njoftim për të kundërtën nga Agjenti.

5.7.2 Gjatë periudhës dhjetë (10)-ditore pas dhënies së çdo njoftimi përcaktimi nga Agjenti sipas klauzolës 5.7.1, secila bankë certifikon një bazë alternative (baza zëvendësuese) për të dhënë ose, sipas rastit, ruajtur kontributin e saj. Baza e zëvendësimit (pa kufizim) mund të përfshijë periudhat alternative të interesit, monedhat alternative ose normat alternative të interesit, por përfshin një marzh mbi koston e fondeve duke përfshirë shpenzimet e detyrueshme, nëse ka, për këtë bankë të barasvlershme me marzhin. Çdo bazë zëvendësimi certifikuar në këtë mënyrë është detyruese për Huamarrësin dhe hyn në fuqi në pajtim me termat e saj nga data e përcaktuar në njoftimin e përcaktimit deri në atë kohë sa Agjenti të njoftojë Huamarrësin që asnjë nga rrethanat e përcaktuara në klauzolën 5.7.1 nuk vazhdon të ekzistojë mbi të cilat zbatohen dispozitat e kësaj Marrëveshjeje që caktojnë normat normale të interesit.

6. Shlyerja, parapagimi dhe anulimi

6.1 Shlyerja

Huamarrësi e shlyen huanë me dhjetë (10) këste, ku secila prej këtyre kësteve duhet të paguhet në secilën prej datave të shlyerjes. Në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, shumat e secilit këst rishlyerjeje është 23 000 000 euro. Nëse shumat e përgjithshme të dhëna nuk tërhiqen plotësisht ose anulohen pjesërisht në pajtim me klauzolën 6.6, shumat e secilit këst shlyerjeje zvogëlohet proporcionalisht.

6.2 Parapagimi vullnetar

Huamarrësi mund të parapaguajë huanë pas përfundimit të periudhës së tërheqjes plotësisht ose pjesërisht (duke qenë 5 000 000 ose një shumë më e madhe që shumë integrale e 1 000 000 euro) në çdo datë të pagimit të interesit në lidhje me pjesën e huasë që duhet të paguhet pa prim ose gjobë. Me njoftimin e dhënë për kryerjen e këtij parapagimi, shumat e përgjithshme të dhëna zvogëlohen me një shumë të barabartë me shumën e këtij parapagimi.

6.3 Parapagimi vullnetar shtesë

Huamarrësi mund të parapaguajë gjithashtu (plotësisht por jo vetëm pjesërisht), pa prim ose gjobë, por pa shkelur detyrimet e tij sipas klauzolave 5.7, 8.5 dhe 13.2:

6.3.1 kontributin e çdo banke ndaj së cilës Huamarrësi ka detyrimin për të paguar shumat shtesë sipas klauzolës 8.5 ose 13.2; ose

6.3.2 kontributin e çdo banke për të cilën zbatohet një bazë zëvendësimi në bazë të klauzolës 5.7.2.

Me dhënien e njoftimit për një parapagesë të tillë, shumat e dhënë e bankës përkatëse reduktohet në zero.

6.4 Shumat e pagueshme gjatë parapagimit

Çdo parapagim në bazë të kësaj Marrëveshjeje bëhet së bashku me:

a) interesin e mbledhur deri në datën e parapagimit (të llogaritur, në rastin e një parapagimi të kontributit të bankës në pajtim me 6.3.2 dhe në lidhje me periudhën gjatë së cilës baza përkatëse e zëvendësimit është zbatuar në pajtim me klauzolën 5.7.2, me një normë vjetore të barabartë me normën e certifikuar nga kjo bankë si normë interesi e barasvlershme me shumën e: i) marzhinit dhe ii) shpenzimeve (duke përfshirë shpenzimet e detyrueshme) të kësaj banke për fondet e kontributit të saj për këtë periudhë);

b) çdo shumë shtesë e pagueshme sipas klauzolës 8.5 ose 13.2; dhe

c) të gjitha shumat e tjera të pagueshme nga Huamarrësi bankës përkatëse sipas kësaj

Marrëveshjeje duke përfshirë, pa kufizim, çdo shumë që paguhet në bazë të klauzolës 12.1.

#### 6.5 Njoftimi i parapagimit

Asnjë parapagim nuk bëhet në bazë të kësaj klauzole 6, përveç kur Huamarrësi i ka bërë Agjentit të paktën një njoftim tridhjetë (30) ditë më parë për synimin e tij për të bërë këtë parapagim. Çdo njoftim për parapagimin ka efekt vetëm me marrjen faktike të tij nga Agjenti, është i parevokueshëm dhe e detyron Huamarrësin të bëjë këtë parapagim në datën e specifikuar. Asnjë shumë e parapaguar sipas kësaj Marrëveshjeje nuk mund të rimerret hua dhe çdo shumë e parapaguar zbatohet për zvogëlimin e kësteve të shlyerjes sipas klauzolës 6.1 në rendin e anasjelltë të datave të kërkueshme për pagesë. Huamarrësi nuk mund të parapaguajë huanë ose një pjesë të saj përveçse në mënyrën e parashikuar shprehimisht në këtë Marrëveshje.

#### 6.6 Anulimi i shumave të dhëna

Huamarrësi, në çdo kohë gjatë periudhës së tërheqjes për një transh, nëpërmjet një njoftimi drejtuar Agjentit (e vlefshme vetëm me marrjen faktike) mund të anulojë me efekt nga një datë jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë pas marrjes nga Agjenti i këtij njoftimi të gjithën ose një pjesë (duke qenë 5 000 000 euro ose një shumë e më e madhe që është një shumë integrale e 5 000 000 euro) të shumave të përgjithshme të dhëna në lidhje me një transh që nuk është tërhequr ose kërkuar në një njoftim tërheqjeje. Çdo njoftim i tillë anulimi, pasi jepet, është i parevokueshëm dhe pasi të hyjë në fuqi ky anulim shumat e dhëna të secilës bankë në lidhje me atë transh zvogëlohen proporcionalisht.

#### 7. Tarifat dhe shpenzimet

##### 7.1 Tarifat

Huamarrësi i paguan Agjentit:

7.1.1 në datën e parë të tërheqjes, për llogarinë e rregulluesve (dhe për ndarje dhe shpërndarje ndërmjet rregulluesve dhe bankave në ato raporte që është rënë dakord veçmas ndërmjet tyre) një tarifë rregullimi për këto shuma që bihet dakord ndërmjet huamarrësit, rregulluesve dhe agjentit në një letër të datës (-) 2008; dhe

7.1.2 në datën e parë të tërheqjes dhe në secilin përvjetor të saj derisa të jenë paguar plotësisht të gjitha paratë në bazë të kësaj Marrëveshjeje, për llogari të Agjentit, një tarifë agjencie të një shume vjetore të rënë dakord ndërmjet Huamarrësit dhe Agjentit në një letër të datës (-) 2008.

Tarifa e referuar në klauzolën 7.1 është e parikthyeshme.

##### 7.2 Shpenzimet

Huamarrësi i paguan Agjentit, me kërkesë:

7.2.1 të gjitha shpenzimet e arsyeshme dhe të dokumentuara që shkaktohen nga kreditorët ose çdonjëri prej tyre në lidhje me negociimin, përgatitjen dhe përfundimin e kësaj Marrëveshjeje dhe dokumenteve të tjera financiare, publikimin e shumëfishtë të huasë dhe të reklamave në lidhje me këtë Marrëveshje (deri në shumën maksimale prej 50 000 euro), e cila: a) përfshin një limit të tarifave ligjore të miratuara nga Norton Rose si këshilltar i Agjentit, në bazë të supozimeve dhe kushteve të angazhimit të tyre, por: b) përjashton kohën e udhëtimit dhe koston e Norton Rose në përputhje me këto kushte, tarifat ligjore të këshilltarit shqiptar për Agjentin, disbursimet e Norton Rose dhe këshilltarit ligjor shqiptar për Agjentin dhe TVSH (nëse ka) mbi tarifat ligjore të Norton Rose dhe këshilltarit ligjor shqiptar për Agjentin kështu që për zërat e përjashtuar në bazë të paragrafëve “a” dhe “b” më lart nga kjo shumë maksimale, Huamarrësi do të jetë përgjegjës për ta rimbursuar Agjentin mbi një shumë të tillë), dhe të çdo amendimi ose zgjatjeje të saj, ose dhënien e një heqje dorë ose pëlqimi në bazë të kësaj Marrëveshjeje ose të një dokumenti tjetër financiar; dhe

7.2.2 të gjitha shpenzimet (duke përfshirë shpenzimet ligjore dhe të paguara nga ai vetë) të shkaktuar nga kreditorët dhe çdonjëri prej tyre (dhe të vërtetuar nga dokumentet shoqëruese sipas rastit) duke pasur parasysh ose në lidhje me ekzekutimin ose ekzekutimin e tentuar, ose ruajtjen ose ruajtjen e tentuar të çdo të drejte sipas kësaj Marrëveshjeje dhe/ose çdo dokument tjetër financiar, së bashku me normën e interesit të përmendur në klauzolën 5.4 nga data në të cilën këto shpenzime u shkaktuan deri në datën e pagesës (si përpara ashtu edhe pas vendimit).

##### 7.3 Tatimi mbi vlerën e shtuar

Të gjitha tarifat dhe shpenzimet e pagueshme në pajtim me këtë klauzolë 7 paguhet së bashku me një shumë të barabartë çdo tatim mbi vlerën e shtuar të pagueshëm nga një Kreditor në lidhje me këto tarifa dhe shpenzime. Çdo tatim mbi vlerën e shtuar në lidhje me çdo shërbim të dhënë nga cilido kreditor në bazë të kësaj Marrëveshjeje dhe/ose çdo dokument tjetër financiar, me dorëzimin e një fature të taksës mbi vlerën e shtuar, paguhet si shtesë mbi çdo shumë të rënë dakord për t'u paguar sipas kësaj

Marrëveshjeje.

#### 7.4 Pullat dhe detyrimet e tjera

Huamarrësi paguan të gjitha detyrimet e pullave, dokumenteve, të regjistrimit ose të tjera, apo tatime (duke përfshirë çdo detyrim ose tatim të pagueshëm ose të vlerësuar për kreditorët ose secilin prej tyre) të vendosura për ose në lidhje me këtë Marrëveshje dhe/ose çdo dokument tjetër financiar ose huanë dhe zhdëmton kreditorët ose cilindo prej tyre ndaj detyrimeve që rrjedhin për shkak të vonesës ose mosveprimit nga Huamarrësi për të paguar këto detyrime dhe tarifa.

### 8. Pagesat dhe tatimet; llogaritë dhe përlllogaritjet

#### 8.1 Mungesa e kompensimit ose kundërpretendimit; shpërndarja te bankat

Huamarrësi pranon që, në përmbushjen e detyrimeve në bazë të kësaj Marrëveshjeje, secila bankë do të marrë përsipër detyrime ndaj palëve të treta në lidhje me financimin e shumave që i jepen Huamarrësit, ku këto detyrime që përkojnë me detyrimet e Huamarrësit ndaj kësaj banke, dhe është e arsyeshme që secila bankë të ketë të drejtën të marrë pagesa bruto nga Huamarrësi në datën e kërkueshme me qëllim që kjo bankë të jetë në gjendje për të përmbushur detyrimet e saj përkatëse ndaj palëve të treta. Po kështu, të gjitha pagesat që duhet të bëhen nga Huamarrësi në bazë të kësaj Marrëveshjeje bëhen të plota, pa asnjë kompensim ose kundërpretendim dhe, në pajtim me parashikimet e klauzolës 8.5, të lirë dhe pa asnjë zbritje ose mbajtje, në euro (përveç shpenzimeve, detyrimeve ose kostove që paguhen në monedhën në të cilën janë shkaktuar) në datën e kërkueshme në llogarinë e Agjentit në atë bankë që Agjenti mund të përcaktojë herë pas here për këtë qëllim. Përveç kur kjo Marrëveshje parashikon që një pagesë të bëhet për llogari të një banke të caktuar (duke përfshirë pa kufizim, klauzolat 5.7, 6.3, 7, 8.5, 12.1, 12.2, 13.1 dhe 13.2) rast në të cilin Agjenti ia bën pagesën përkatëse bankës së interesuar, pagesat që bëhen nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje janë për llogari të të gjitha bankave dhe Agjenti i shpërndan menjëherë këto pagesa në fondet përkatëse siç merren nga Agjenti tek Bankat proporcionalisht në pajtim me shumën e dhëna ose kontributet e tyre, sipas rastit.

#### 8.2 Pagesat nga bankat

Të gjitha shumat që i jepen nga Bankat Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje dërgohen në euro në datën përkatëse të tërheqjes në llogarinë e Agjentit në atë bankë që Agjenti mund të ketë njoftuar bankat dhe paguhet nga agjenti në atë datë në fondet përkatëse që merren nga Agjenti në llogarinë e Huamarrësit të përcaktuar në njoftimin përkatës të tërheqjes.

#### 8.3 Ditët jobankare

Nëse një pagesë, sipas kësaj Marrëveshjeje, do të bëhet përndryshe e kërkueshme në një ditë që nuk është ditë bankare, data e kërkueshme për pagesën shtyhet në ditën paguese bankare, përveç kur një ditë e tillë bankare bie në muajin tjetër kalendarik, rast në të cilin pagesa bëhet në ditën bankare pararendëse.

#### 8.4 Agjenti mund të prezumojë marrjen

Nëse një shumë duhet t'i paguhet sipas kësaj Marrëveshjeje Agjentit për llogari të një personi tjetër, Agjenti mund të prezumojë që pagesa do të bëhet kur bëhet e kërkueshme dhe (por nuk është i detyruar) mund t'ia vërë shumën në dispozicion personit që ka këtë të drejtë. Nëse provohet të jetë rasti që kjo pagesë nuk i është bërë Agjentit, personi të cilit i është vënë në dispozicion kjo shumë me kërkesë ia riimburson këtë shumë Agjentit së bashku me interesin mbi të të mjaftueshëm për të kompensuar Agjentin për shpenzimet e ofrimit të një shume të tillë deri në datën e kësaj shlyerjeje dhe personi nga i cili kërkohej kjo shumë zhdëmton Agjentin për çdo ose të gjithë dëmin ose shpenzimet që Agjenti mund të ketë pësuar ose shkaktuar si pasojë e mospagesës së kësaj shume në datën e kërkueshme të saj.

#### 8.5 Shtimi i shumës për tatimet nga Huamarrësi

Nëse në një moment Huamarrësit i kërkohet të bëjë zbritje ose mbajtje në lidhje me tatimet nga një pagesë e kërkueshme sipas kësaj Marrëveshjeje për llogari të një kreditori (ose nëse Agjentit i kërkohet të bëjë këto zbritje ose mbajtje nga një pagesë për një kreditor tjetër), shuma e kërkueshme prej Huamarrësit në lidhje me këtë pagesë rritet në masën e nevojshme për të siguruar që, pas bërjes së këtyre zbritjeve ose mbajtjeve, secili kreditor të marrë në datën e kërkueshme për këto pagesa (dhe mban, të lirë nga çdo detyrim në lidhje me këtë zbritje ose mbajtje) një shumë neto të barabartë me shumën që ai do të kishte marrë nëse nuk do të kërkoheshin këto zbritje ose mbajtje dhe Huamarrësi zhdëmton menjëherë çdo kreditor ndaj çdo humbjeje ose shpenzimi të shkaktuar nga secili prej tyre për shkak të moskryerjes nga Huamarrësi i këtyre zbritjeve ose mbajtjeve, ose për shkak të një pagese të shtuar që nuk bëhet në datën e kërkueshme për këtë pagesë. Huamarrësi i paraqet menjëherë Agjentit çdo faturë, certifikatë ose

provë tjetër që provon shumat (nëse ka) e paguara ose të pagueshme në lidhje me këto zbritje ose mbajtje.

#### 8.6 Llogaritë bankare

Secila bankë mban, në pajtim me praktikat e saj të zakonshme, një ose disa llogari që evidentojnë shumat herë pas here të dhëna hua, që janë marrë hua dhe që i paguhen asaj në pajtim me këtë Marrëveshje. Agjenti mban një llogari kontrolli që tregon çdo paradhënie, transh ose, sipas rastit, huanë dhe shuma të tjera që janë marrë hua nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje dhe të gjitha pagesat në lidhje me to të bëra nga Huamarrësi herë pas here. Llogaria e kontrollit, në mungesë të një gabimi të dukshëm, është përfundimtare në lidhje me shumën herë pas here që është marrë hua nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje.

#### 8.7 Pagesat e pjeshme

Nëse në një datë në të cilën bëhet e kërkueshme një pagesë që duhet të bëhet nga Huamarrësi sipas një dokumenti financiar, shuma e marrë nga Agjenti prej Huamarrësit është më e vogël se shuma e plotë e pagesës së kërkueshme që duhet të bëhet nga Huamarrësi në atë datë, pa cenuar ndonjë të drejtë ose mjetet mbrojtëse në dispozicion të kreditorëve ose të ndonjërit prej tyre sipas kësaj Marrëveshjeje dhe/ose çdo dokumenti tjetër financiar, Agjenti zbaton shumën e marrë faktikisht prej Huamarrësit në përmbushje të detyrimeve të Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje dhe të dokumenteve të tjera financiare, në rendin e mëposhtëm, pavarësisht nga ndonjë përshtatje të bërë ose që synohet të bëhet, nga Huamarrësi:

8.7.1 *së pari*, për ose drejt pagesës, me bazë proporcionale, të çdo tarife, shpenzimi ose kostoje të paguar të Agjentit në pajtim me këtë Marrëveshje ose dokumenteve të tjera financiare;

8.7.2 *së dyti*, për ose drejt pagesës së rregulluesve, me bazë proporcionale, të çdo pjese të tarifës së rregullimit që paguhet në pajtim me klauzolën 7.1.1 që mbetet e paguar;

8.7.3 *së treti*, për ose drejt pagesës së bankave, me një bazë proporcionale, të çdo kostoje dhe shpenzimi që shkaktohet prej tyre në bazë të kësaj Marrëveshjeje ose të çdo dokumenti tjetër financiar;

8.7.4 *së katërti*, për ose drejt pagesës së bankave, me një bazë proporcionale, të çdo interesi të mbledhur që është bërë i kërkueshëm por mbetet i paguar;

8.7.5 *së pesti*, për ose drejt pagesës së bankave, me një bazë proporcionale, të çdo shume principale që është bërë e kërkueshme por mbetet e paguar; dhe

8.7.6 *së gjashti*, për ose drejt pagesës së çdo shume tjetër që është bërë e kërkueshme, por mbetet e paguar (dhe, nëse mbetet e paguar më shumë se një shumë, me bazë proporcionale).

Rendi i zbatimit të përcaktuar në paragrafët 8.8.2 -8.8.6 (përfshirë) ndryshohet nga Agjenti nëse bankat e shumicës udhëzojnë kështu, pa referencë, pëlqim ose aprovim nga Huamarrësi.

#### 8.8 Përlllogaritjet

Të gjitha pagesat e interesit dhe të tjera të një natyre vjetore sipas kësaj Marrëveshjeje mblidhen nga dita në ditë dhe përlllogariten mbi bazën e ditëve faktike të kaluara dhe një viti me 360 ditë. Në përlllogaritjen e numrit faktik të ditëve të kaluara në një periudhë që është një prej serisë së periudhave të njëpasnjëshme pa intervale ndërmjet tyre ose një periudhë në ditën e fundit duhet të bëhet një pagesë në lidhje me këtë periudhë, dita e parë e kësaj periudhe do të përfshihet, por dita e fundit përjashtohet.

#### 8.9 Certifikatat përfundimtare

Çdo certifikatë ose përcaktim i Agjentit ose i një banke në lidhje me një normë interesi ose një shumë të pagueshme në pajtim me këtë Marrëveshje, në mungesë të gabimit të dukshëm, është përfundimtare dhe detyruese për Huamarrësin dhe (në rastin e një certifikate ose përcaktimi nga Agjenti) për bankat.

#### 9 Përfaqësimet dhe garancitë

##### 9.1 Përfaqësimet dhe garancitë në vazhdimësi

Huamarrësi përfaqëson dhe garanton për secilin nga kreditorët për:

##### 9.1.1 Tagrin për të marrë hua

Huamarrësi ka tagrin të përfundojë, dorëzojë dhe përmbushë detyrimet e tij në bazë të dokumenteve financiare dhe të marrë hua shumat e përgjithshme të dhëna; janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të autorizuar përfundimin, dhënien dhe përmbushjen e dokumenteve financiare dhe nuk tejkalohej asnjë kufi i tagreve të tij si rezultat e huamarrjes në bazë të kësaj Marrëveshjeje;

##### 9.1.2 Besimin dhe kreditë e plotë

Ministri i Financave i Huamarrësit, duke vepruar në emër të Këshillit të Ministrave të Huamarrësit, ka tagrin dhe autoritetin e plotë dhe të pakushtëzuar të Huamarrësit për të marrë përsipër

dokumente financiare në emër të Huamarrësit dhe shpreh besimin e plotë dhe kredinë e Huamarrësit për përmbushjen e duhur nga Huamarrësi të detyrimeve të tij në bazë të dokumenteve financiare;

#### 9.1.3 Detyrimet detyruese

Kjo Marrëveshje dhe dokumentet e tjera financiare përbëjnë detyrime të vlefshme dhe ligjërishit detyruese të Huamarrësit të ekzekutueshme në pajtim me termat e tyre përkatës;

#### 9.1.4 Detyrimet e drejtpërdrejta, të përgjithshme dhe të pakushtëzuara

Detyrimet e Huamarrësit, sipas dokumenteve financiare, janë të drejtpërdrejta, të përgjithshme dhe të pakushtëzuara të Huamarrësit, e renditen të paktën me të njëjtën preferencë si të gjitha detyrimet e tjera të tashme dhe të ardhshme të pasiguruara dhe të preferuara me përjashtim të ndonjë detyrimi që është në radhë preferenciale në bazë të ligjit dhe jo të kontratës;

#### 9.1.5 Moskonfliktimin me detyrimet e tjera

Përfundimi dhe dhënia e marrja hua e shumave të përgjithshme të dhëna dhe përmbushja e detyrimeve të tij sipas dhe në pajtim me dispozitat e dokumenteve financiare nga Huamarrësi: i) nuk vjen në kundërshtim me Kushtetutën Shqiptare ose ndonjë ligj ekzistues, statut, rregull, rregullore apo vendim, dekret ose leje të zbatuar së cilës i nënshtrohet Huamarrësi; ii) nuk konflikton më, ose si rezultat i një shkeljeje të një prej termave të, ose nuk përbën mospërmbushje, sipas një traktati, marrëveshjeje ose instrumenti tjetër bilateral ose multilateral tek i cili Huamarrësi është palë, ose së cilës i nënshtrohet ai ose një prej pasurive të tij; ose iii) nuk rezulton në krijimin ose caktimin, apo nuk detyron Huamarrësin për të krijuar ndonjë rëndim barësor mbi ndonjë nga ndërmarjet, sendet pasurore, të drejtat ose të ardhurat e Huamarrësit;

#### 9.1.6 Pëlqimet e marra

Çdo pëlqim, autorizim, licencë ose aprovim, ose regjistrim apo deklarim tek organet qeveritare ose publike apo autoritetet ose gjykatat që kërkohet nga Huamarrësi për të autorizuar ose kërkohet nga Huadhënësi në lidhje me përfundimin, dhënen, vlefshmërinë, ekzekutueshmërinë ose pranueshmërinë në prova të dokumenteve financiare ose përmbushjen nga Huamarrësi të detyrimeve të tij në bazë të një prej dokumenteve financiare është marrë ose kryer dhe është në fuqi dhe me efekt të plotë dhe nuk ka pasur mospërmbushje në realizimin e kushteve ose kufizimeve (nëse ka) të caktuara mbi të, ose në lidhje me të njëjtën;

#### 9.1.7 Moskërkimin e parashtrimeve

Nuk është e nevojshme të sigurohet ligjshmëria, vlefshmëria, ekzekutueshmëria ose pranueshmëria e provave për ndonjë dokument financiar ose që ai ose një instrument tjetër të noterohet, paraqitet, regjistrohesh, shënohet në ndonjë gjykatë, zyrë publike apo gjetkë në Shqipëri, apo të paguhet ndonjë pullë, taksë regjistrimi apo e ngjashme në Shqipëri në lidhje me këtë Marrëveshje dhe çdo dokument financiar është në formë të përshtatshme për ekzekutimin e tij në gjykata në Shqipëri;

#### 9.1.8 Mungesën e gjykimeve

Asnjë gjykim, arbitrazh ose procedurë administrative nuk po zhvillohet, nuk është e pambaruar ose, sipas mendimit të Huamarrësit, nuk kërcënon Huamarrësin që do të kishte efekte materiale të kundërta ose aftësinë e Huamarrësit për të përmbushur detyrimet sipas një dokumenti financiar;

#### 9.1.9 Asnjë mospërmbushje

Huamarrësi nuk është (dhe as nuk do të ishte, duke bërë njoftimin ose nëpërmjet parashkrimit ose përmbushjen e një kushti tjetër apo një kombinim të tyre) në shkelje ose në mungesë sipas një marrëveshjeje të caktuar në lidhje me qenien në detyrim ku ai është palë ose nëpërmjet së cilës ai mund të detyrohet dhe asnjë mospërmbushje tjetër nuk ka ndodhur apo është duke vazhduar;

#### 9.1.10 Pasqyrat

Pasqyra e balancës së pagesave të Huamarrësit në lidhje me vitin kalendarik që përfundon më 31 dhjetor 2006 siç i jepet Agjentit është përgatitur sipas standardit të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe pasqyra për përbërjen e zotërimeve të floririt, këmbimit valutor dhe të drejtat e veçanta të tërheqjes të Huamarrësit në lidhje me vitin kalendarik që përfundon më 31 dhjetor 2006 që i jepet Agjentit është i vërtetë, i plotë dhe i saktë në të gjitha aspektet;

#### 9.1.11 Mungesën e ndryshimeve materiale negative

Nuk ka pasur ndryshim material negativ në pozicionin financiar të Huamarrësit nga i përcaktuar në pasqyrat e klauzolës 9.1.10;

#### 9.1.12 Anëtarësinë e institucioneve ndërkombëtare

Huamarrësi është anëtar në pozitë të mirë i Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe nuk është caktuar asnjë kufizim në përdorimin prej tij të

burimeve të institucioneve për shkak të mospërbushjes së detyrimeve të veta si anëtar i një prej këtyre institucioneve;

#### 9.1.13 Zgjedhjen e ligjit

Zgjedhja nga Huamarrësi e ligjit anglez për të rregulluar dokumentet financiare dhe nënshtrimi nga Huamarrësi të juridiksioni joekskluziv i gjykatave angleze janë të vlefshme dhe detyruese;

#### 9.1.14 Mungesën e imunitetit

Me përjashtim të sendeve pasurore që futen brenda dispozitave të nenit 11 paragrafi 2 i Kushtetutës Shqiptare dhe në bazë të dispozitave të ligjit shqiptar nr.8743, datë 22 shkurt 2001 “Mbi pasurinë e paluajtshme shtetërore” në lidhje pronën publike dhe regjimin e saj ligjor:

a) Huamarrësi i nënshtrohet ligjit civil dhe tregtar në lidhje me detyrimet e tij sipas dokumenteve financiare;

b) çdo huamarrje nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje dhe ekzekutimi, dorëzimi dhe përmbushja e detyrimeve të tij sipas dokumenteve financiare nga Huamarrësi përbëjnë akte private dhe tregtare të bëra për qëllime private dhe tregtare;

c) as Huamarrësi dhe asnjë prej sendeve të tij pasurore nuk ka të drejtën e imunitetit për shkaqe të sovranitetit ose ndryshe nga veprimet ose procedimet ligjore (që përfshijnë, pa kufizim, gjykimin, sigurimin e padisë para vendimit, ekzekutimin apo një përmbushje tjetër) dhe heqja dorë që parashikohet në klauzolën 18.3 e secilës prej këtyre të drejtave të imunitetit është e pakthyeshme dhe detyruese për Huamarrësin.

#### 9.1.15 Mosmbajtjen e taksave

Nuk vendoset asnjë taksë nëpërmjet mbajtjes ose ndryshe për një pagesë që duhet të bëhet nga Huamarrësi sipas dokumenteve financiare ose që vendosen mbi ose nëpërmjet ekzekutimit ose dorëzimit nga Huamarrësi të një prej dokumenteve financiare ose ndonjë instrumenti tjetër që duhet të përfundohet ose dorëzohet sipas dokumenteve financiare ose ndonjë prej tyre; dhe

#### 9.1.16 Përmbushjen e pëlqimeve dhe licencave

Çdo pëlqim, autorizim, licencë ose aprovim që kërkohet nga Huamarrësi në lidhje me zhvillimin e biznesit të tij dhe pronësinë, përdorimin, shfrytëzimin ose zënien e pasurive ose sendeve pasurore të tij është marrë dhe është me efekt të plotë, dhe nuk ka pasur mospërmbushje në lidhje me respektimin e kushteve dhe kufizimeve (sipas rastit) të vendosura, ose, në lidhje me këtë, sipas dijenisë së Huamarrësit nuk ka lindur asnjë rrethanë për shkak të së cilës është i nevojshëm një veprim korigjues nga, ose me shpenzime të Huamarrësit, sipas ose në pajtim me ligjin ose rregulloren e zbatueshme për biznesin, pasurinë ose sendet pasurore të Huamarrësit.

### 9.2 Përsëritjen

Përfaqësimet dhe garancitë e klauzolës 9.1 (dhe në mënyrë të tillë që përfaqësimi dhe garancia në klauzolën 9.1.10 për këtë qëllim u referohen pasqyrave të fundit që i jepen Agjentit sipas klauzolës 10.1.5) mendohet të përsëriten nga Huamarrësi në dhe që nga data e tërheqjes dhe çdo datë e pagesës së interesit sikur të bëhej në lidhje me referencën tek faktet dhe rrethanat që ekzistojnë në atë ditë.

## 10 Sipërmarrjet

### 10.1 Sipërmarrjet në përgjithësi

Huamarrësi merr përsipër për çdo kreditor që, nga data e kësaj Marrëveshjeje dhe për sa kohë paratë nuk janë shlyer sipas kësaj Marrëveshjeje ose mbeten në dispozicion për t'u tërhequr nga Huamarrësi, ai:

#### 10.1.1 Njoftimi i Mospërmbushjes

Menjëherë sapo të vihet në dijeni për këtë, do të informojë Agjentin për çdo ngjarje që mund të ndikojë negativisht në aftësinë e tij për të përmbushur detyrimet sipas një dokumenti financiar dhe për çdo mospërmbushje, dhe herë pas here, nëse kjo kërkohet nga Agjenti, i konfirmon Agjentit me shkrim që, përveç kur deklarohet ndryshe në këtë informacion, asnjë mospërmbushje nuk ka ndodhur dhe nuk po vazhdon;

#### 10.1.2 Pëlqimet dhe licencat

Pa cenuar klauzolat 3 dhe 9.1, do të marrë ose marrë masa për të marrë, mbajtur në fuqi dhe efekt të plotë dhe përmbushur në të gjitha aspektet materiale kushtet dhe kufizimet (sipas rastit) të caktuara, ose në lidhje me çdo pëlqim, autorizim, licencë ose aprovim të organeve ose autoriteteve qeveritare ose publike ose gjykatave dhe ndërmerr ose merr masa për të ndërmarrë të gjitha aktet dhe sendet e tjera që mund të jenë të nevojshme ose të dëshirueshme herë pas here sipas ligjit të zbatueshëm

për përmbushjen e vazhdueshme dhe të rregullt të të gjitha detyrimeve të Huamarrësit sipas dokumenteve financiare.

#### 10.1.3 Përdorimi i shumave

Do të përdorë shumat nga tërheqjet sipas kësaj Marrëveshjeje ekskluzivisht për qëllimin e përcaktuar në klauzolën 1.1;

#### 10.1.4 Vendosja në pozita të barabarta

Do të sigurojë që detyrimet e Huamarrësit sipas dokumenteve financiare, pa cenuar dispozitat e klauzolës 10.2, do të jenë gjithmonë në pozitë të barabartë me të gjitha detyrimet e tjera të tashme dhe të ardhme, të siguruara dhe në radhë preferenciale, me përjashtim të ndonjë detyrimi të preferuar në mënyrë të detyrueshme me ligj dhe jo me kontratë;

#### 10.1.5 Dorëzimi i pasqyrave

Brenda nëntëdhjetë (90) ditëve pas fundit të secilit vit kalendarik do t'i dorëzojë Agjentit, për t'i shpërndarë nëpër Banka dhe në kopje të mjaftueshme për të gjitha Bankat, një pasqyrë të balancës së pagesave të Huamarrësit për këtë periudhë, të përgatitur në formën standard të Fondit Monetar Ndërkombëtar;

#### 10.1.6 Raporti vjetor

Menjëherë pas publikimit të tij, do t'i dorëzojë Agjentit për ta shpërndarë te bankat dhe në kopje të mjaftueshme për të gjitha bankat, raportin vjetor të Bankës së Shqipërisë;

#### 10.1.7 Dhënia e informacionit shtesë

Do t'i japë Agjentit atë informacion tjetër në lidhje me gjendjen financiare dhe monetare të Huamarrësit që Agjenti ose çdo bankë (që vepron nëpërmjet Agjentit) mund të kërkojë herë pas here në mënyrë të arsyeshme;

#### 10.1.8 Miratimi i legjisllacionit

Do të informojë menjëherë Agjentin për miratimin e çdo ligji ose ndodhinë e një ngjarjeje tjetër, si rezultat i së cilës, ose janë dhënë mendime në kuptimin e grafikut 6 (të ndryshëm nga paragrafi (-)) (mungesa e taksave), ose në kuptimin e grafikut 7 (të ndryshëm nga paragrafi (-)) (mungesa e taksave) menjëherë pas kësaj ndodhie, një mendim i tillë nuk do të ishte i vërtetë dhe i saktë në të gjitha aspektet;

#### 10.1.9 Përmbushja e ligjeve dhe rregulloreve

Do të përmbushë dhe marrë masa që Huamarrësi dhe çdo subjekt qeveritar, funksionet kompetencat, operacionet dhe aktivitetet e të cilit lidhen me qëllimin ose përmbushjen e kësaj Marrëveshjeje, të përmbushin termat dhe kushtet e të gjitha ligjeve, rregulloreve, marrëveshjeve, licencave dhe materialit të koncesioneve për kryerjen e punës së tij; dhe

#### 10.1.10 Banka e Shqipërisë

a) Do të sigurojë që Banka e Shqipërisë do t'i ofrojë Huamarrësit gjithmonë fonde të lira dhe lehtësisht të transferueshme në euro dhe çdo pëlqim që mund të jetë i nevojshëm për t'u marrë nga Banka e Shqipërisë, me qëllim që t'i mundësohet Huamarrësit të përmbushë të gjitha detyrimet e tij për pagesa në euro sipas dokumenteve financiare siç dhe kur ato bëhen të kërkueshme; dhe

b) do të sigurojë që Banka e Shqipërisë ka gjithmonë të drejta të plota të pronësisë mbi sendet pasurore dhe rezervat monetare ndërkombëtare të Shqipërisë dhe merr masa që Banka e Shqipërisë të ushtrojë gjithmonë autoritet, tagër dhe kontroll të plotë mbi to;

#### 10.2 Pengu negativ

Huamarrësi merr përsipër për çdo kreditor që, nga data e kësaj Marrëveshjeje dhe për sa kohë paratë nuk janë shlyer sipas kësaj Marrëveshjeje ose mbeten në dispozicion për t'u tërhequr nga Huamarrësi, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Agjentit që vepron në bazë të udhëzimeve të bankave të shumicës:

ai nuk do të lejojë:

a) asnjë rëndim barësor nga Huamarrësi të ekzistojë, lindë, krijohet ose zgjerohet mbi të gjitha ose një pjesë të ndërmarrjes, sendeve pasurore, të drejtave, ose të ardhurave të tyre përkatëse, të tashme dhe të ardhshme, të Huamarrësit; ose

b) asnjë nga detyrimet e Huamarrësit të garantohet nga çdo person tjetër, përveç kur ky rëndim barësor ose përfitim nga kjo garanci, apo mjet tjetër për sigurimin e kredisë që bankat e shumicës mund ta konsiderojnë ekuivalente me të, shtrihet në të njëjtën kohë në mënyrë të barabartë dhe proporcionale me detyrimet e Huamarrësit sipas dokumenteve financiare që pranohet nga Agjenti.

## 11. Raste të mospërmbushjes

11.1 Secila prej ngjarjeve ose rrethanave të caktuara më poshtë është një rast i mospërmbushjes (pavarësisht nëse është shkaktuar nga një shkak jashtë kontrollit të Huamarrësit):

11.1.1 Mospagesa. Huamarrësi nuk paguan një shumë të kërkueshme sipas kësaj Marrëveshjeje në monedhën, në kohën dhe në mënyrën e parashikuar nga kjo Marrëveshje; ose

11.1.2 Shkelja e detyrimeve të caktuara. Huamarrësi kryen një shkelje ose nuk vepron për të përmbushur një prej detyrimeve ose sipërmarrjeve të tij që duhet të kryhet prej tij në bazë të një dokumenti financiar (të ndryshëm nga mospagesa e një shume kur bëhet e kërkueshme) dhe në lidhje me secilën prej kësaj shkeljeje ose mosveprimi që sipas mendimit të bankave të shumicës është në gjendje të bëjë korrigjimin, ky veprim që mund të kërkohej prej Agjentit nuk është ndërmarrë brenda katërmbëdhjetë (14) ditëve që kur Agjenti njofton Huamarrësin për këtë mospërmbushje dhe për këtë veprim që kërkohej; ose

11.1.3 Keqpërfaqësimi. Çdo përfaqësim ose garanci e dhënë ose që mendohet të jepet ose përsëritet nga ose në lidhje me Huamarrësin në ose në pajtim me dokumentet financiare ose në ndonjë prej tyre, ose në një njoftim, certifikatë ose pasqyrë të përmendur ose dhënë sipas dokumenteve financiare ose njërit prej tyre është ose vërtetohet të ketë qenë e pasaktë ose e gabuar në një aspekt material; ose

11.1.4 Mospërmbushje e dyfishtë. Çdo borxh i jashtëm i Huamarrësit nuk paguhet kur është i kërkueshëm ose bëhet (me anë të deklaratës ose automatikisht në pajtim me marrëveshjen ose instrumentin përkatës që përbën të njëjtën) i kërkueshëm dhe i pagueshëm para datës kur ai përndryshe do të bëhej i kërkueshëm ose çdo kreditor i Huamarrësit fiton të drejtën të deklarojë çdo borxh të jashtëm të Huamarrësit që është bërë i kërkueshëm dhe i pagueshëm ose të kërkojë kolektarizim në para ose garanci për çdo borxh të tillë të jashtëm ose çdo program ose shumë të dhënë që i ofrohet Huamarrësit në lidhje me borxhin e jashtëm tërhiqet, pezullohet ose anulohet për shkak të mospërmbushjes (megjithatë të përshkruar) të personit përkatës dhe, në një rast të tillë, shuma, ose shuma e përgjithshme në çdo kohë, e të gjithë borxhit të jashtëm, në lidhje me të cilin një nga ngjarjet e mësipërme ka ndodhur dhe vazhdon, është e barabartë ose më e madhe se 5 000 000 euro ose ekuivalenti i saj në monedhën në të cilën kjo përcaktohet dhe është e pagueshme; ose

11.1.5 Mospërmbushja e kontratës së prejardhur. Huamarrësi nuk bën pagesën në lidhje me një kontratë të prejardhur në lidhje me çdo shumë në ditën e saj të kërkueshme ose pala tjetër në një kontratë të prejardhur fiton të drejtën të prishë këtë kontratë të prejardhur më herët për shkak të mospërmbushjes nga ana e Huamarrësit dhe detyrimi i prejardhur neto i Huamarrësit, në tërësi, në bazë të gjithë kontratave të tyre të prejardhura në momentin përkatës nuk është më pak se 5 000 000 euro (ose ekuivalenti në monedhën përkatëse në të cilën ajo përcaktohet); ose

11.1.6 Procesi ligjor. Çdo vendim ose urdhër i nxjerrë kundër Huamarrësit nuk pezullohet ose përmbushet brenda shtatë (7) ditëve, ose kreditori bën sigurimin ose merr në zotërim, ose një proces sigurimi, ekzekutimi ose sekuestrimi vihet ose ekzekutohet apo zbatohet gjyqësisht ndaj çdo pjese materiale të ndërmarrjes, sendeve pasurore, të drejtave ose të ardhurave të Huamarrësit dhe nuk zbatohet brenda shtatë (7) ditësh; ose

11.1.7 Mospagimi i borxheve. Huamarrësi ndalon ose pezullon pagesën e borxheve të tij ose është ose mendohet, për qëllimet e një ligji, i paaftë ose pranon paaftësinë për të paguar borxhet e tij ndërsa ata bëhen të kërkueshëm ose fillon negociata me një ose më shumë nga kreditorët e tij me qëllim rirregullimin ose riskedjulimin e përgjithshëm të një pjese të borxhit të tij të jashtëm ose propozon ose hyn në një përbërje ose një masë tjetër në interes të kreditorëve përgjithësisht ose çdo klase të kreditorëve ose ka filluar gjykimi në lidhje me Huamarrësin në bazë të një ligji, rregulloreje ose procedurë në lidhje me rindërtimin, ose rirregullimin e borxheve ose Huamarrësi deklaron ose cakton një moratorium mbi pagesën e një pjese të borxhit të tij të jashtëm; ose

11.1.8 Paaftësia paguese e një subjekti qeveritar përkatës. Çdo subjekt qeveritar, funksionet, kompetencat, operacionet ose aktivitetet e tij kanë të bëjnë me qëllimin e përmbushjes së Marrëveshjes, ndërmerr çdo veprim ose çdo procedim gjyqësor fillohet apo ndërmerren masa të tjera për: i) këtë subjekt qeveritar të gjykohej, konstatohej i falimentuar ose i paaftë për të paguar; ii) likuidimi ose shpërbërja e këtij subjekti qeveritar; ose iii) emërimin e një likuiduesi, administratori, të besuari apo nëpunësi tjetër të ngjashëm për këtë subjekt qeveritar ose të gjithë apo një pjesë të ndërmarrjes, sendeve pasurore, të drejtave ose të ardhurave të tij; ose

11.1.9 Gjykim analog. Ndodh, në lidhje me Huamarrësin, në një vend ose territor juridiksionit

të gjykatave të të cilit u nënshtrohet, një ngjarje që, sipas mendimit të arsyeshëm të Agjentit, duket që në atë vend ose territor të korrespondojë, ose të ketë efekt ekuivalent ose të ngjashëm me ato të përmendura në klauzolat 11.1.6 – 11.1.8 (përfshirë); ose

11.1.10 Anëtarësia e institucioneve ndërkombëtare. Huamarrësi pushon së qeni anëtar në pozitë të mirë i Fondit Monetar Ndërkombëtar ose i Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim ose i një pasuesi të tyre, ose punon së qeni i përshtatshëm për të përdorur burimet e këtyre institucioneve (ose të një pasuesi të tyre); ose

11.1.11 Paligjshmëria. Bëhet e paligjshme për Huamarrësin për të përmbushur rregullisht dhe shpejt një prej detyrimeve që merret përsipër prej tij në bazë të një prej dokumenteve financiare ose çdo dokument financiar për një arsye të caktuar pushon së qeni në fuqi dhe me efekt të plotë nga ana e Huamarrësit; ose

11.1.12 Legjislacioni, ankimi ose procedimi. Çdo legjislacion propozohet ose miratohet ose një ankim ose procedim para një autoriteti gjyqësor, administrativ, qeveritar ose një autoriteti tjetër fillohet për të parandaluar ose kufizuar përmbushjen nga Huamarrësi të një prej dokumenteve financiare ose për të testuar ligjshmërinë, vlefshmërinë ose ekzekutueshmërinë e një dokumenti financiar nga ana e Huamarrësit; ose

11.1.13 Mospranimi. Huamarrësi nuk pranon ndonjë nga dokumentet financiare ose ndërmerr, rregullon apo lejon ndërmarrjen e një veprimi ose sendi që provon synimin për të mos pranuar një nga dokumentet financiare; ose

11.1.14 Ndryshimi negativ material. Ndodh, sipas mendimit të bankave të shumicës, një ndryshim material negativ në gjendjen financiare të Huamarrësit duke iu referuar pasqyrave të përmendura në klauzolën 9.1.10; ose

11.1.15 Ngjarje materiale. Ndodh një ngjarje tjetër ose lind një rrethanë që, sipas mendimit të bankave të shumicës, mund të ndikojë materialisht dhe negativisht aftësinë e Huamarrësit për të përmbushur të gjitha ose një nga detyrimet sipas ose në pajtim me termat e një prej dokumenteve financiare.

## 11.2 Përsheptimi

Agjenti, dhe nëse kjo kërkohet nga bankat e shumicës, pa cenuar ndonjë të drejtë tjetër të bankave, në momentin pas rastit të mospërmbushjes, me një njoftim drejtuar Huamarrësit, mund të deklarojë që:

11.2.1 detyrimi i secilës bankë për të ofruar shumat e dhëna është ndërprerë, dhe shumat e përgjithshme të dhëna reduktohen menjëherë në zero; dhe/ose

11.2.2 huaja dhe interesi i mbledhur dhe të gjitha shumat e tjera të pagueshme në bazë të kësaj Marrëveshjeje janë bërë menjëherë të kërkueshme dhe të pagueshme ose janë bërë të kërkueshme dhe të pagueshme me kërkesë, këto, menjëherë ose në pajtim me termat e këtij njoftimi, bëhen të kërkueshme dhe të pagueshme.

## 11.3 Baza e kërkesës

Nëse, në pajtim me klauzolën 11.2.2, Agjenti deklaron që huaja është e kërkueshme dhe e pagueshme me kërkesë, Agjenti (dhe, nëse udhëzohet kështu nga bankat e shumicës) në çdo kohë, nëpërmjet njoftimit me shkrim drejtuar Huamarrësit: a) mund të kërkojë shlyerjen e Huasë në atë datë që mund të përcaktohet në këtë njoftim, nëpërmjet të cilit huaja bëhet e pagueshme në datën e përcaktuar së bashku me interesin e mbledhur dhe të gjitha shumat e pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje; ose b) tërheqë këtë deklaratë me efekt nga data e përcaktuar në këtë njoftim.

## 12. Zhdëmtimet

### 12.1 Zhdëmtime të ndryshme

Huamarrësi zhdëmton me kërkesë çdo kreditor, pa cenuar asnjë nga të drejtat e tyre të tjera sipas kësaj Marrëveshjeje, ndaj humbjeve (dukë përfshirë humbjen e marzhit) ose ndaj atyre shpenzimeve që ky kreditor i provon si të pësuar ose shkaktuara si pasojë e:

12.1.1 një mospërmbushje në pagesën nga Huamarrësi të një shume sipas kësaj Marrëveshjeje kur bëhet e kërkueshme;

12.1.2 ndodhisë së një rasti të mospërmbushjes;

12.1.3 një parapagesë të të gjithë ose një pjese të huasë që bahet në bazë të klauzolës 6.3 ose klauzolës 13.1 të ndryshme nga data e pagesës së interesit në lidhje me pjesën e huasë së parapaguar; ose

12.1.4 një paradhënie që nuk është bërë për një shkak të caktuar (duke përjashtuar çdo mospërmbushje të kreditorit) pas një njoftimi tërheqjeje që është dhënë,

duke përfshirë, në këtë rast, por duke mos u kufizuar, në një humbje ose shpenzim që pësohet ose shkaktohet nga kjo bankë në mbajtjen ose financimin e të gjithë ose një pjesë të kontributit të saj, ose në likuidimin ose riangazhimin e depozitave nga palët e treta të përfuara ose kontraktuara për të financuar të gjithë ose një pjesë të kontributit ose një shumë tjetër që i është marrë hua kësaj banke.

#### 12.2 Monedha e llogarisë; zhdëmtimi i monedhës

Asnjë pagesë e Huamarrësit në bazë të kësaj Marrëveshjeje që bëhet në një monedhë të ndryshme nga monedha (monedha kontraktuale) në të cilën kjo pagesë kërkohet të bëhet në pajtim me këtë Marrëveshje nuk e shlyen detyrimin në lidhje me të cilën është bërë përveç në masën që shuma neto në monedhën kontraktuale të përfuara nga Agjenti me shitjen e monedhës së marrë, pas marrjes parasysht të çdo premieje dhe shpenzimi të këmbimit në lidhje me këtë shitje. Për mënjanimin e dyshimit Agjenti dhe bankat nuk janë të detyruara të pranojnë një pagesë të tillë në një monedhë të ndryshme nga monedha kontraktuale dhe Agjenti ose bankat nuk janë të detyruara ndaj Huamarrësit për ndonjë humbje ose humbje të reklamuar që rrjedh nga luhatjet e kurseve të këmbimit ndërmjet datës në të cilën kjo pagesë merret nga Agjenti dhe datës në të cilën Agjenti kryen shitjen, për të cilën Agjenti ka (si ndaj Huamarrësit) një diskrecion absolut. Nëse një shumë që kërkohet prej Huamarrësit në bazë të kësaj Marrëveshjeje ose të një urdhri ose vendimi të dhënë në lidhje me të kërkohet të konvertohet nga monedha kontraktuale ose monedha në të cilën kjo paguhet në bazë të këtij urdhri ose vendimi (monedha e parë) në një monedhë tjetër (monedha e dytë) për qëllimin e: a) ngritjes ose depozitimit të një pretendimi ose prove kundër Huamarrësit; b) përfitimit të një urdhri ose vendimi në një gjykatë ose tribunal tjetër; ose c) ekzekutimin e një urdhri ose vendimi të dhënë në lidhje me këtë Marrëveshje, Huamarrësi zhdëmtton dhe ruan nga dëmi çdo kreditor ndaj çdo dëmi të vuajtur si rezultat i një diference ndërmjet: i) kursit të këmbimit që përdoret për këtë qëllim për të konvertuar shumën në fjalë nga monedha e parë në monedhën e dytë; dhe ii) kursit ose kurseve të këmbimit në të cilët ky kreditor në ushtrimin e zakonshëm të aktivitetit blen monedhën e parë me monedhën e dytë me marrjen e një shumë të paguar në përmbushje, plotësisht ose pjesërisht, të këtij urdhri, vendimi, pretendimi ose prove. Çdo shumë që kërkohet prej Huamarrësit në bazë të zhdëmtimit të parashikuar në klauzolën 12.2 kërkohet si borxh i veçantë dhe nuk ndikohet nga vendimi që përftohet për një shumë tjetër të kërkueshme në bazë ose në lidhje me këtë Marrëveshje dhe termi “kursi i këmbimit” përfshin çdo premie dhe shpenzimet e këmbimit që paguhet në lidhje me blerjen e monedhës së parë me monedhën e dytë.

#### 13 Paligjshmëria dhe shpenzimet e rritura; zvogëlimi

##### 13.1 Paligjshmëria

Nëse është ose vjen në kundërshtim me një ligj ose rregullore për një bankë të kontribuojë tek një paradhënie ose të mbajë shumat e saj të dhëna ose financojë kontributin e saj, kjo bankë, me anë të Agjentit, njofton menjëherë Huamarrësin dhe pas kësaj: a) shumat e dhëna të kësaj banke reduktohen në zero; dhe b) Huamarrësi është i detyruar të parapaguajë kontributin e kësaj banke; i) menjëherë; ose ii) në një datë të përcaktuar më vonë që nuk është më herët se data e fundit që lejohet nga ligji ose rregullorja përkatëse. Një parapagim në pajtim me këtë klauzolë 13.1 bëhet së bashku me të gjitha shumat e përmendura në klauzolën 6.4.

##### 13.2 Shpenzimet e rritura

Nëse rezultati i një ndryshimi në, ose në interpretimin ose zbatimin, ose prezantimin e një ligji apo rregulloreje, kërkese apo rregulli (pavarësisht nëse ka fuqinë e ligjit, por nëse nuk ka forcën e ligjit, me të cilin banka përkatëse ose, sipas rastit, shoqëria e saj zotëruese zakonisht e zbaton), duke përfshirë (pa kufizim) ato që kanë të bëjnë me tatimin, përshtatshmërinë e kapitalit, likuiditetin, sendet pasurore rezervë, depozitat proporcionale në para dhe depozitat e veçanta,

13.2.1 ia nënshtron një Banke tatimet ose ndryshon bazën e tatimeve të një banke në lidhje me një pagesë sipas kësaj Marrëveshjeje (të ndryshme nga taksat ose tatimet mbi të ardhurat e përgjithshme neto, fitimet e kësaj bankë të caktuara në juridiksionin ku ndodhet zyra kryesore ose huadhënëse në bazë të kësaj Marrëveshjeje); dhe/ose

13.2.2 rrit koston ose cakton kosto shtesë mbi një bankë ose shoqërinë e saj zotëruese duke ofruar ose mbajtur të ofrueshme të gjithë ose një pjesë të shumave të dhëna të bankës ose mbajtjen ose financimin e të gjithë ose një pjesë të kontributit të bankës; dhe/ose

13.2.3 zvogëlon shumën e pagueshme ose kthimin efektiv tek një bankë në bazë të kësaj Marrëveshjeje; dhe/ose

13.2.4 pakësojnë normën e kthimit të bankës ose të shoqërisë zotëruese mbi kapitalin e saj të përgjithshëm për shkak të një ndryshimi në mënyrën në të cilën kërkohet për të alokuar burimet e

kapitalit në detyrimet e kësaj banke në bazë të kësaj Marrëveshjeje; dhe/ose

13.2.5 i kërkon çdo banke ose shoqërisë së saj zotëruese për të bërë një pagesë ose të heqin dorë nga një kthim i llogaritur në lidhje me ose mbi një shumë të marrë ose që mund të merret nga banka në bazë të kësaj Marrëveshjeje; dhe/ose

13.2.6 i kërkon çdo banke ose shoqërisë së saj zotëruese për t'iu nënshtruar një humbjeje (duke përfshirë një humbje të fitimeve potenciale të ardhshme) për shkak të qenies i detyruar për të zbritur të gjitha ose një pjesë të shumave të dhëna të bankës ose kontributi nga kapitali i saj për qëllime rregullatore,

dhe në çdo rast të tillë (por në pajtim me klauzolën 13.3):

a) kjo bankë njofton Huamarrësin nëpërmjet një Agjenti me shkrim për këtë ngjarje menjëherë sapo të marrë dijeni për këtë; dhe

b) Huamarrësi, me kërkesë të bërë në një kohë kur pavarësisht nëse është shlyer kontributi i kësaj banke, i paguan Agjentit për llogari të kësaj banke shumën që përcakton kjo bankë (në një certifikatë që cakton bazën për llogaritjen e kësaj shume por që nuk përfshin asnjë çështje që kjo bankë ose shoqëria e saj zotëruese e konsideron konfidenciale) dhe kërkohet për të kompensuar këtë bankë dhe/ose shoqërinë e saj zotëruese për këtë detyrim për taksat, koston e rritur ose shtesë, pakësimin, pagesën, kthimin e lënë ose humbjen.

Për qëllimet e kësaj klauzole 13.2 dhe klauzolës 13.4, "shoqëria zotëruese" është, në lidhje me bankën, shoqëria ose subjekti (nëse ka) brenda mbikëqyrjes së konsoliduar të të cilës kjo bankë përfshihet.

### 13.3 Përjashtimet

Asgjë në klauzolën 13.2 nuk i jep të drejtë një banke për të marrë një shumë në lidhje me kompensimin për një detyrim të tillë për taksat, kostoja e rritur ose shtesë, pakësim, pagesë, kthim i lënë ose humbje në masën që kjo:

13.3.1 merret parasysh në përlllogaritjen e koston detyruese (sipas rastit); ose

13.3.2 i nënshtrohet një pagese shtesë në bazë të klauzolës 8.5.

### 13.4 Pakësimi

Nëse lindin rrethana që do të rezultojnë, ose do të rezultojnë nëpërmjet njoftimit, në:

13.4.1 kërkesën për Huamarrësin të bëjë një pagesë të shtuar për një bankë në pajtim me klauzolën 8.5;

13.4.2 pakësimin e shumës së dhënë të një banke në zero ose në kërkesën për Huamarrësin të parapaguajë një kontribut për një bankë në pajtim me klauzolën 13.1; ose

13.4.3 kërkesën për Huamarrësin të bëjë një pagesë për një bankë për të kompensuar këtë bankë ose shoqërinë e saj zotëruese për një për një detyrim për taksat, koston e rritur ose shtesë, reduktimin, pagesën kthimin e lënë ose humbjen në pajtim me klauzolën 13.2.2,

pastaj, pa kufizuar, pakësuar apo kualifikuar ndryshe në asnjë mënyrë detyrimet e Huamarrësit sipas klauzolës 8 dhe kësaj klauzole 13, kjo bankë, duke u konsultuar me Agjentin, përpiqet të marrë ato hapa të matur (dhe/ose, në rastin e klauzolës 13.2.2 dhe nëse kostoja e rritur ose e shtuar, reduktimi, pagesa, kthimi i lënë ose humbja është i asaj të shoqërisë zotëruese, përpiqet të rregullojë që kjo shoqëri zotëruese të ndërmarrë këta hapa të arsyeshëm) që janë të mundur për të (ose, sipas rastit, shoqërinë e saj zotëruese) për të pakësuar ose hequr këto rrethana (duke përfshirë (në rastin e kësaj banke) transferimin e të drejtave dhe detyrimeve të saj sipas kësaj Marrëveshjeje tek një bankë ose institucion financiar tjetër të pranueshëm për Huamarrësin), përveç kur ndërmarrja e këtyre hapave (sipas mendimit të kësaj banke) mund të jetë dëmtuese për këtë bankë (ose, sipas rastit, për shoqërinë e saj zotëruese) ose është në konflikt me politikat e përgjithshme të kësaj banke (ose, sipas rastit, të shoqërisë e saj zotëruese) apo përfshin këtë bankë ose (ose, sipas rastit, për shoqërinë e saj zotëruese) në shpenzime ose barrën e rritur administrative.

## 14 Kompensimi dhe pagesat proporcionale

### 14.1 Kompensimi

Huamarrësi autorizon çdo kreditor të zbatojë çdo balancë krediti për të cilën ai ka të drejtë në një prej llogarive të tij me këtë kreditor në një prej degëve të tij në ose drejt përmbushjes së një shumë që është e kërkueshme dhe e pagueshme nga Huamarrësi për këtë kreditor sipas kësaj Marrëveshjeje. Për këtë qëllim secili kreditor është i autorizuar të blejë me paratë që janë në kredinë e kësaj llogarie ato monedha të tjera që mund të jenë të nevojshme për të bërë të mundur këtë zbatim. Asnjë kreditor nuk është i detyruar për të ushtruar një të drejtë që i jepet nga kjo klauzolë 14.1. Secili kreditor njofton

Agjentin dhe Huamarrësin (duke dhënë hollësi të plota) menjëherë në lidhje me ushtrimin ose ushtrimin e synuar të një të drejte të kompensimit dhe Agjenti njofton kreditorët e tjerë.

#### 14.2 Pagesat proporcionale

14.2.1 Nëse në një kohë para njoftimit që është dhënë nga Agjenti në pajtim me klauzolën 11.2.2, çdo bankë (banka rikuperuese) merr dhe rikuperon çdo shumë që është marrë hua prej saj nga Huamarrësi në bazë të dokumenteve të financimit nëpërmjet pagesës së drejtpërdrejtë, kompensimit ose në një mënyrë të ndryshme nga pagesa nëpërmjet Agjentit në pajtim me klauzolat 8.1 ose 8.7 (duke mos qenë një pagesë e marrë nga një zëvendësues ose një nënpjesëmarrës në kontributin e kësaj banke ose një pagesë tjetër e një shume që është marrë hua prej bankës rikuperuese për llogarinë e saj të vetme në pajtim me klauzolat 5.7, 6.3, 7, 8.5, 12.1, 12.2, 13.1, 13.2, banka rikuperuese, brenda dy (2) ditëve bankare nga kjo marrje ose rikuperim (marrja përkatëse) njofton agjentin për shumën e marrjes përkatëse. Nëse marrja përkatëse e kalon shumën që banka rikuperuese do të kishte marrë nëse marrja përkatëse do të ishte marrë nga Agjenti dhe shpërndarë në pajtim me klauzolën 8.1 ose 8.7 (sipas rasti) atëherë:

a) brenda dy (2) ditëve bankare nga kërkesa e Agjentit, banka rikuperuese i paguan Agjentit një shumë të barabartë (ose ekuivalentin) me tepricën;

b) Agjenti e trajton tepricën e paguar në këtë mënyrë nga banka rikuperuese sikur të ishte një pagesë e bërë nga Huamarrësi dhe e shpërndan këtë te bankat (e ndryshme nga banka rikuperuese) në pajtim me klauzolën 8.7; dhe

c) ndërmjet Huamarrësit dhe bankës rikuperuese teprica e rishpërndarë në këtë mënyrë trajtohet sikur nuk është paguar, por detyrimet e Huamarrësit për bankat e tjera, në masën e shumës së rishpërndarë atyre, trajtohen si të përmbushura.

14.2.2 Nëse një pjesë e marrjes përkatëse duhet të rifinancohet më vonë tërësisht ose pjesërisht nga banka rikuperuese (qoftë te likuidatori, ose ndryshe), secila bankë tek të cilat një pjesë e kësaj marrjeje përkatëse ishte shpërndarë në këtë mënyrë, me kërkesë nga banka rikuperuese i shlyen bankës rikuperuese atë pjesë proporcionale të kësaj banke të shumës që duhet të rifinancohet nga banka rikuperuese.

14.2.3 Secila bankë i paraqet Agjentit me kërkesë atë informacion që Agjenti mund të kërkojë herë pas here për qëllimet e kësaj klauzole 14.2.

14.2.4 Pavarësisht dispozitave të mësipërme të kësaj klauzole 14.2, asnjë bankë rikuperuese nuk është e detyruar të ndajë një faturë përkatëse që ajo merr ose rikuperon në pajtim me procedurat ligjore të filluara prej saj për të rikuperuar shumat që i janë huajtur asaj në pajtim me këtë Marrëveshje me ndonjë palë tjetër që ka një të drejtë ligjore por nuk bashkohet në këto procedura dhe nuk fillon apo ndjek me kujdes procedura të veçanta për të realizuar të drejtat e saj në të njëjtën gjykatë apo tjetër (përveç kur procedimi i nisur nga banka rikuperuese fillohet prej saj para se Agjenti të ketë bërë njoftim në pajtim me klauzolën 11.2.2 dhe banka rikuperuese nuk ka bërë njoftim të mëparshëm për këtë palë nëpërmjet Agjentit).

14.2.5 Për mënjanimin e dyshimit, pas një njoftimi të dhënë nga Agjenti në pajtim me klauzolën 11.2.2 secila bankë rikuperuese ka të drejtë të mbajë për llogari të vet çdo faturë përkatëse.

#### 14.3 Moslirimi

Për mënjanimin e dyshimit deklarohet që mospërmbushja nga një bankë rikuperimi i dispozitave të klauzolës 14.2 nuk e liron asnjë bankë tjetër rikuperimi nga ndonjë prej detyrimeve të saj në bazë të klauzolës 14.2.

#### 14.4 Mungesa e tarifës

Dispozitat e kësaj klauzole 14 nuk përbëjnë dhe nuk interpretohen të përbëjnë një tarifë nga një bankë mbi të gjithë shumën ose një pjesë të saj të marrë ose rikuperuar prej saj në rrethanat e përmendura në klauzolën 14.2.

#### 15 Transferimi, zëvendësimi dhe zyrat e huadhënies

##### 15.1 Përfitimi dhe barra

Kjo Marrëveshje është detyruese dhe është për përfitimin e kreditorëve, Huamarrësit dhe pasuesve të tyre në titull.

##### 15.2 Mostransferimi nga Huamarrësi

Huamarrësi nuk mund të transferojë ose ndryshe kalojë të drejtat ose detyrimet e tij në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

##### 15.3 Zëvendësimi

Secila bankë (një bankë ekzistuese) mund të transferojë (në pajtim me klauzolën 15.9), me anë të zëvendësimit (por jo nëpërmjet transferimit apo ndryshe) të gjitha ose një pjesë të të drejtave, përfitimeve dhe/ose detyrimeve në bazë të kësaj Marrëveshjeje te një person tjetër (një zëvendësues) pa pëlqimin e Huamarrësit, por me pëlqimin paraprak me shkrim të Agjentit. Çdo zëvendësim i tillë kryhet me një njoftim prej jo më pak se pesë (5) ditë bankare nëpërmjet dorëzimit tek Agjenti i një certifikate zëvendësimi të mbushur rregullisht dhe të përfunduar rregullisht nga banka ekzistuese dhe zëvendësuesit. Në datën e hyrjes në fuqi (sipas përcaktimit dhe përkufizimit në certifikatën e zëvendësimit të përfunduar në këtë mënyrë dhe dorëzuar), në masën që shumat e dhëna dhe kontributi i bankës ekzistuese janë shprehur në një certifikatë zëvendësimi që i nënshtrohet zëvendësimit në favor të zëvendësuesit të kryer në pajtim me klauzolën 15.3, nëpërmjet siglimit të certifikatës së zëvendësimit nga Agjenti (për vete dhe palët e tjera në këtë Marrëveshje):

15.3.1 palët ekzistuese në këtë Marrëveshje dhe banka ekzistuese lirohen nga detyrimet e tyre përkatëse ndaj njëra-tjetrës sipas kësaj Marrëveshjeje (detyrimet e çliruara) dhe të drejtat e tyre përkatëse ndaj njëra-tjetrës sipas kësaj Marrëveshjeje (të drejtat e çliruara) anulohen;

15.3.2 pala zëvendësuese në certifikatën përkatëse të zëvendësimit dhe palët ekzistuese në këtë Marrëveshje (të ndryshme nga kjo bankë ekzistuese) marrin përsipër detyrime ndaj njëra-tjetrës që ndryshojnë nga detyrimet e çliruara në masën që ato janë të huajtura dhe merren përsipër nga ky zëvendësues në vend të bankës ekzistuese; dhe

15.3.3 pala zëvendësuese në certifikatën përkatëse të zëvendësimit dhe palët ekzistuese në këtë Marrëveshje (të ndryshme nga kjo bankë ekzistuese) marrin të drejta ndaj njëra-tjetrës që ndryshojnë nga të drejtat e çliruara në masën që ato janë të ushtrueshme nga dhe ndaj këtij zëvendësuesi në vend të bankës ekzistuese,

dhe, në këtë datë të hyrjes në fuqi, zëvendësuesi i paguan Agjentit për llogari të vet një tarifë prej 1500 euro së bashku me të gjitha shpenzimet, tarifat dhe shpenzimet (duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në tarifat dhe shpenzimet ligjore) dhe të gjithë taksën mbi vlerën e shtuar, të verifikuar nga Agjenti që është shkaktuar prej tij në lidhje me këtë zëvendësim. Agjenti njofton menjëherë bankat e tjera dhe Huamarrësin për marrjen prej tij të çdo certifikate zëvendësimi dhe i jep menjëherë një kopje të kësaj certifikate zëvendësimi Huamarrësit.

#### 15.4 Mbështetja mbi certifikatën e zëvendësimit

Agjenti dhe Huamarrësi kanë plotësisht të drejtë të mbështeten mbi çdo certifikatë zëvendësimi të dhënë Agjentit në pajtim me dispozitat e mësipërme të kësaj klauzole 15 që është e plotë dhe e rregullt në paraqitje në lidhje me përmbajtjen dhe konsiderohet e nënshkruar në emër të bankës përkatëse ekzistuese dhe zëvendësuesit dhe as Agjenti dhe Huamarrësi nuk ka ndonjë detyrim ose përgjegjësi ndaj ndonjë pale si pasojë e vendosjes së besimit dhe veprimit në pajtim me një certifikatë të tillë zëvendësimi nëse ajo provohet të mos jetë e vërtetë apo rregullisht e autorizuar.

#### 15.5 Autorizimi i Agjentit

Secila palë në këtë Marrëveshje autorizon në mënyrë të pakthyeshme Agjentin të siglojë secilën certifikatë zëvendësimi në emër të tij për qëllimet e klauzolës 15.3 pa pëlqim, konsultim tjetër me Huamarrësin apo këtë palë.

#### 15.6 Interpretimi i referencave të caktuara

Nëse një bankë zëvendësohet në një prej të drejtave, përfitimeve ose detyrimeve të saj sipas parashikimit në klauzolën 15.3, të gjitha referencat përkatëse në këtë Marrëveshje për tek kjo bankë pas kësaj interpretohen si një referencë tek kjo bankë dhe/ose zëvendësuesi i saj në masën e interesave të tyre përkatëse.

#### 15.7 Zyrat huadhënëse

Secila bankë jep hua nëpërmjet zyrës së saj në adresën e përcaktuar në grafikun 1 ose, sipas rastit, në çdo certifikatë zëvendësimi përkatëse ose nëpërmjet një zyre tjetër të kësaj banke të përzgjedhur herë pas here nga kjo bankë nëpërmjet së cilës kjo bankë dëshiron të japë hua për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje. Nëse zyra nëpërmjet së cilës një bankë po jep hua ndryshohet në pajtim me këtë klauzolë 15.7, kjo bankë njofton menjëherë Agjentin për këtë ndryshim.

#### 15.8 Deklarimi i informacionit

Çdo bankë mund t'i deklarojë një të transferuari të mundshëm ose çdo personi tjetër që mund të propozojë të hyjë në marrëdhënie kontraktuale me këtë bankë në lidhje me këtë Marrëveshje atë informacioni në lidhje me Huamarrësin që kjo bankë e konsideron të përshtatshme.

#### 15.9 Kufizimi i zëvendësimeve

Nëse një pjesë zëvendësohet në një pjesë të të drejtave, përfitimeve dhe detyrimeve të saj në pajtim me klauzolën 15.3, ajo bankë duhet të zëvendësohet në pjesë të barabarta të shumave të dhëna dhe kontributit (nëse ka) dhe, nëse në momentin kur ky zëvendësim ndodh nuk është kryer më shumë se një paradhënie, zëvendësimi i kontributit të saj hyn në fuqi në lidhje me të njëjtën pjesë të secilës paradhënieje. Certifikata e zëvendësimit në lidhje me çdo zëvendësim të tillë kryhet përkatësisht.

16 Rregulluesit, Agjenti dhe bankat e referencës

#### 16.1 Emërimi i Agjentit

Secila bankë emëron në mënyrë të pakthyeshme Agjentin si agjentin e saj për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje dhe dokumenteve të tjera financiare dhe autorizon Agjentin në mënyrë të pakthyeshme:

16.1.1 të përfundojë secilin prej dokumenteve financiare dhe të gjithë ata dokumente që mund të aprovohet nga bankat e shumicës nga Agjenti; dhe

16.1.2 (pavarësisht nëse nëpërmjet punonjësve ose agjentëve) të ndërmarrë atë veprim në emër të bankës dhe të ushtrojë ato të drejta, veprime ndreqëse, tagre dhe kompetenca që i delegohen në mënyrë specifike Agjentit në bazë të kësaj Marrëveshjeje, ose sipas rastit, dokumentet e tjerë financiare, së bashku me ato kompetenca dhe diskrecione që shkojnë në mënyrë të arsyeshme me to (por duke iu nënshtruar çdo kufizimi të përcaktuar në këtë Marrëveshje). Agjenti, megjithatë, nuk ka detyrë, detyrim apo përgjegjësi (qoftë mirëbesimi apo tjetër) ndaj bankave tej atyre që parashikohen shprehimisht në këtë Marrëveshje dhe/ose dokumentet e tjera financiare.

#### 16.2 Veprimet e Agjentit

Çdo veprim i ndërmarrë nga Agjenti në bazë të ose në lidhje me këtë Marrëveshje dhe/ose dokumentet e tjerë financiarë me autoritetin e duhur, ose në bazë të udhëzimeve përkatëse, të marra nga bankat e shumicës (ose siç autorizohet ndryshe rregullisht) është detyruese për të gjitha bankat.

#### 16.3 Detyrat e Agjentit

Agjenti:

16.3.1 njofton menjëherë secilën bankë për përmbajtjen e secilit njoftim, certifikatë ose dokument tjetër që merret nga Agjenti nga Huamarrësi në pajtim ose në bazë të 10.1.1, 10.1.5, 10.1.6 dhe 10.1.7; dhe

16.3.2 (në pajtim me dispozitat e tjera të kësaj klauzole 16) ndërmerr atë veprim ose, sipas rastit, vetëkufizohet në ndërmarrjen e këtij veprimi në lidhje me ushtrimin e të drejtave, mjeteve korrigjuese, tagreve dhe kompetencave si agjent, siç mund të udhëzojnë në mënyrë të arsyeshme bankat e shumicës.

#### 16.4 Të drejtat e Agjentit

Agjenti:

16.4.1 në ushtrim të çdo të drejte, mjeti korrigjues, kompetence ose tagri në lidhje me çdo çështje, ose në çdo kontekst, që nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Marrëveshje ose dokumente të tjera financiare, mund të veprojë ose, sipas rastit, të mos veprojë në pajtim me udhëzimet e bankave të shumicës, dhe është plotësisht i mbrojtur për ta bërë këtë;

16.4.2 nëse dhe deri sa nuk ka marrë udhëzime nga bankat e shumicës, mund të marrë atë veprim ose të mos e marrë atë veprim në lidhje me një mospërmbushje për të cilën Agjenti ka dijeni siç mund të duket e këshillueshme për interesat e larta të bankës (por nuk është i detyruar për ta bërë këtë);

16.4.3 mund të mos veprojë në pajtim me një udhëzim të bankave të shumicës për të filluar një proces gjyqësor që lind ose është në lidhje me këtë Marrëveshje ose dokumentet financiare derisa ai të zhdëmtohet dhe/ose sigurohet duke u pranuar prej tij ndaj çdo dhe të gjithë koston, shpenzimeve ose detyrimeve (duke përfshirë tarifat ligjore) që ai do të ose mund të shkaktonte si rezultat i kësaj;

16.4.4 mund të konsiderojë dhe mund të trajtojë: i) secilën bankë si personin që ka të drejtë në interes të kontributit të kësaj banke për të gjithë qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, nëse dhe derisa një certifikatë zëvendësimi nuk është paraqitur tek Agjenti dhe nuk ka hyrë në fuqi; dhe ii) zyra e vendosur përballë emrit të bankës në grafikun 1, ose sipas rastit, në çdo certifikatë zëvendësimi si zyrë huadhënieje të kësaj banke, nëse dhe derisa një njoftim me shkrim për ndryshimin e zyrës së huadhënies nuk është marrë nga Agjenti; dhe Agjenti mund të veprojë mbi bazën e këtij njoftimi përveç kur ky zëvendësohet me një njoftim tjetër;

16.4.5 të mbështetet në lidhje me çështjet faktike që mund të priten në mënyrë të arsyeshme të jenë brenda njohurive të Huamarrësit në një certifikatë të nënshkruar nga një (drejtor) (nëpunës) i Huamarrësit në emër të Huamarrësit; dhe

16.4.6 të mos kryejë asnjë që do të ose mund, sipas mendimit të tij, të ishte në kundërshtim me

një ligj ose rregullore të një juridiksioni dhe mund të bëjë gjithçka që sipas mendimit të tij është e nevojshme ose e dëshirueshme për të përmbushur këtë ligj ose rregullore.

#### 16.5 Mungesa e përgjegjësisë për rregulluesit dhe Agjentin

As rregulluesit, as Agjenti apo ndonjë prej punonjësve ose agjentëve të tyre përkatës:

16.5.1 nuk është i detyruar të kërkojë një certifikatë ose mendim sipas klauzolës 3.4 ose klauzolës 10.1 apo të bëjë ndonjë hetim në lidhje me përdorimin e shumave të Huasë, përveç kur (në rastin e Agjentit) kjo kërkohet me shkrim nga një bankë, dhe në këtë rast Agjenti bën menjëherë kërkesën e duhur të Huamarrësit; ose

16.5.2 nuk janë të detyruar të bëjnë hetime në lidhje me një shkelje ose mospërmbushje të Huamarrësit në përmbushjen ose respektimin e çdo dispozite të kësaj Marrëveshjeje apo në lidhje me ekzistencën e një mospërmbushjeje përveç kur (në rastin e Agjentit) Agjenti ka dijeni faktike për të dhe është njoftuar për këtë nga një bankë, dhe në këtë rast Agjenti njofton menjëherë bankat për ngjarjen ose rrethanën përkatëse; ose

16.5.3 nuk është i detyruar të hetojë nëse një përfaqësim apo garanci e dhënë nga Huamarrësi në pajtim me këtë Marrëveshje ose dokument financiar është e vërtetë; ose

16.5.4 nuk është i detyruar të bëjë asgjë (duke përfshirë pa kufizim, deklarin e një dokumenti ose informacioni) që do të, ose sipas mendimit të tij mund të ishte në kundërshtim me një ligj ose rregullore ose në shkelje të një detyrimi konfidencialiteti apo ndryshe i diskutuar dhe do ta bënte atë përgjegjës para një personi tjetër; ose

16.5.5 nuk është i detyruar të përgjigjet para një bankë për një shumë ose elementin e fitimit të një shume të marrë prej tij për llogari të tij; ose

16.5.6 nuk është i detyruar të fillojë procedime gjyqësore që lindin ose janë në lidhje me, apo të ndërmarra masa për të ekzekutuar këtë Marrëveshje ose një dokument tjetër financiar të ndryshme nga ato në udhëzimet e bankave të shumicës; ose

16.5.7 nuk është i detyruar ndaj asnjë banke për një veprim të kryer ose të moskryer në bazë të ose në lidhje me këtë Marrëveshje ose një dokument tjetër financiar ose huanë, përveç kur është i shkaktuar nga neglizhenca e hapur ose sjellje e qëllimshme.

Për qëllimet e kësaj klauzole 16, Agjenti nuk trajtohet sikur ka njohuri faktike për një çështje për të cilën financa e korporatës ose një ndarje tjetër jashtë agjencisë ose departamentit të administrimit të huasë së personit që për momentin vepron si Agjent mund të marrë dijeni në kontekstin e aktiviteteve korporative të financës, këshilluese ose huadhënëse herë pas here të ndërmarra nga Agjenti për Huamarrësin ose çdo subjekt qeveritar ose shoqëri të asociuara ose një person tjetër që mund të jetë një konkurrent tregtar i Huamarrësit apo mund të ketë ndryshe interesa tregtare të ngjashme me ato të Huamarrësit.

#### 16.6 Mosmbështetja mbi rregulluesit ose Agjentin

Secila bankë pranon, nëpërmjet ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje ose, sipas rastit, një certifikate zëvendësimi, që ajo nuk është mbështetur në një deklarin, mendim, parashikim apo përfaqësim tjetër të bërë nga rregulluesi ose Agjenti për ta detyruar atë të lidhë këtë Marrëveshje dhe ajo ka lidhur dhe do të vazhdojë të bëjë, pa u mbështetur tek Agjenti apo cilido rregullues dhe bazuar në ato dokumente që ai i konsideron të përshtatshme, vlerësimin e vet për aftësinë për të marrë kredi të Huamarrësit dhe të gjithë subjekteve qeveritare dhe hetimin e tij të pavarur të gjendjes financiare, prospekteve dhe çështjeve të Huamarrësit dhe të subjekteve qeveritare në lidhje me marrjen dhe vazhdimin e huasë sipas kësaj Marrëveshjeje. Asnjë prej rregulluesve dhe as Agjenti nuk ka ndonjë përgjegjësi ose detyrë, qoftë fillimisht apo në një bazë të vazhduar, t'i japë bankës informacion krediti apo tjetër në lidhje me huamarrësin qoftë duke ardhur në zotërimin e tij para dhënies së një paradhënieje apo në një moment të mëvonshëm, ndryshe nga (në rastin e Agjentit) sa parashikohet në klauzolën 16.3.1.

16.7 Mungesa e përgjegjësisë për rregulluesit ose Agjentin për përmbushjen e detyrimeve të Huamarrësit

As rregulluesit dhe as Agjenti nuk ka përgjegjësi ose detyrim ndaj një banke:

16.7.1 për shkak të mospërmbushjes nga Huamarrësi të detyrimeve sipas një dokumenti financiar; ose

16.7.2 për gjendjen financiare të Huamarrësit ose të një subjekti qeveritar; ose

16.7.3 për plotësinë ose saktësinë e deklaratave, përfaqësimeve ose garancive në këtë Marrëveshje ose në një dokument tjetër financiar ose çdo dokument të dhënë në bazë të kësaj

Marrëveshjeje ose çdo dokument tjetër financiar; ose

16.7.4 për ekzekutimin, efektivitetin, përshtatshmërinë, legjitimitetin, vlefshmërinë, ekzekutueshmërinë ose pranueshmërinë në mbështetje të kësaj Marrëveshjeje ose çdo dokumenti financiar apo të çdo certifikate, raporti, ose dokumenti tjetër të përfunduar ose dhënë në bazë të kësaj Marrëveshjeje ose të një dokumenti financiar; ose

16.7.5 për hetimin ose kryerjen e hetimeve në titullin e Huamarrësit në lidhje me një prej pasurive ose sendeve pasurore të tij; ose

16.7.6 ndryshe në lidhje me huanë ose negocimin e saj ose për të vepruar (ose sipas rastit, mos vepruar) në pajtim me udhëzimet e bankave të shumicës.

16.8 Mbështetja mbi dokumentet dhe këshillën profesionale

Secili nga rregulluesit dhe Agjenti ka të drejtë të mbështetet mbi çdo komunikim, instrument ose dokument që besohet prej tij të jetë i vërtetë dhe i saktë dhe të jetë nënshkruar ose dërguar nga personi i duhur dhe ka të drejtë të mbështetet në lidhje me çështjet ligjore dhe të tjera profesionale mbi mendimet dhe deklaratimet e çdo këshilltari ligjor ose profesional të zgjedhur ose aprovuar prej tij (duke përfshirë ata që janë në punësimin e Agjentit).

16.9 Marrëdhënie të tjera

Secili prej rregulluesve dhe Agjenti, pa pasur detyrimin të raportojë tek bankat, mund të pranojë depozitat, të japë hua dhe të përfshihet përgjithësisht në çdo lloj aktiviteti bankar ose tjetër dhe të japë shërbime këshillimi dhe të tjera për Huamarrësin ose një subjekt tjetër qeveritar ose shoqëritë e asociuara ose çdo bankë sikur të mos ishte rregulluesi ose Agjenti, sipas rastit.

16.10 Të drejtat e Agjentit si bankë; mungesa e partneritetit

Në lidhje me shumat e vetë të dhëna dhe kontributin (nëse ka) Agjenti ka të njëjtat të drejta dhe tagre sipas kësaj Marrëveshjeje dhe dokumenteve të tjerë financiare si çdo bankë tjetër dhe mund t'i ushtrojë këto sikur të përmbushte detyrat dhe funksionet e deleguara atij në bazë të kësaj Marrëveshjeje dhe/ose një dokumenti tjetër financiar dhe termi "Bankat", nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe, përfshin Agjentin në zotësinë e tij individuale si një bankë. Kjo Marrëveshje nuk është dhe nuk interpretohet të përbëjë një partneritet ndërmjet palëve ose me ndonjë prej tyre.

16.11 Amendimet, heqjet dorë

16.11.1 Në pajtim me klauzolën 16.11.2, Agjenti, me pëlqimin e bankave të shumicës, mund (ose nëse dhe në masën e autorizuar shprehimisht nga dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje ose të një dokumenti tjetër financiar) dhe, nëse udhëzohet kështu nga bankat e shumicës, duhet: i) të bjerë dakord me amendimet ose modifikimet e kësaj Marrëveshjeje dhe/ose një Dokumenti tjetër financiar me Huamarrësin; dhe/ose ii) të ndryshojë të mos pretendojë shkeljen e, ose mospërmbushjen, apo të justifikojë ndryshe përmbushjen e një dispozite të kësaj Marrëveshjeje ose të një dokumenti tjetër financiar nga Huamarrësi. Një veprim i tillë i autorizuar dhe zbatuar nga Agjenti dokumentohet në atë mënyrë që përcakton Agjenti (me aprovimin e bankave të shumicës), u njoftohet bankave menjëherë nga Agjenti dhe (pa cenuar përgjithësimin e klauzolës 16.2) është detyruese për të gjitha bankat.

16.11.2 Përveç kur është me pëlqimin paraprak të shkruar të të gjithë bankave, Agjenti nuk ka autoritetin që në emër të bankave të bjerë dakord me Huamarrësin për amendime ose modifikime të kësaj Marrëveshjeje ose të një dokumenti tjetër financiar ose të lejojë heqjen dorë në lidhje me shkeljen ose mospërmbushjen ose për të ndryshuar apo justifikuar përmbushjen e ose në bazë të kësaj Marrëveshjeje ose të një dokumenti tjetër financiar nga Huamarrësi, nëse efekti i këtij ndryshimi, modifikimi, heqje dorë, verifikimi ose justifikimi do të ishte: i) reduktimi i marzhit; ii) shtyrja e datës së kërkueshme ose reduktimi i shumës së një pagese të shumës principale, interesit ose të shumave të tjera të pagueshme nga Huamarrësi në bazë të kësaj Marrëveshjeje dhe/ose të një dokumenti tjetër financiar; iii) ndryshimi i monedhës në të cilën një shumë e caktuar është e pagueshme nga Huamarrësi në bazë të kësaj Marrëveshjeje dhe/ose të një dokumenti tjetër financiar; iv) rritja e shumës së dhënë nga banka; v) zgjatja e periudhës së tërheqjes ose datën e pushimit të fuqisë; vi) ndryshimi i përkufizimit të "bankat e shumicës" në klauzolën 1.2; vii) ndryshimi i çdo dispozite të kësaj Marrëveshjeje dhe/ose të një dokumenti tjetër financiar që parashikon shprehimisht aprovimin ose pëlqimin e të gjitha bankave të tillë që aprovimi ose pëlqimi përkatës të mund të jepet ndryshe nga sanksioni i të gjitha bankave; viii) ndryshimi i radhës së shpërndarjes në bazë të klauzolës 8.7; ix) ndryshimi i klauzolës 14.2; ose x) ndryshimi i kësaj klauzole 16.11.

16.12 Rimbursimi dhe zhdëmtimi i bankave

Secila bankë rimburson çdo rregullues dhe Agjentin (proporcionalisht në pajtim me shumat e

dhëna dhe kontributet e kësaj banke), në masën që rregulluesi përkatës ose Agjenti nuk riimbursohet nga Huamarrësi për shpenzimet, tarifat dhe shpenzimet e shkaktuara nga ky rregullues ose, sipas rastit, Agjenti në lidhje me negocimin, përgatitjen, botimin dhe përfundimin e kësaj Marrëveshjeje dhe/ose çdo dokumenti financiar dhe/ose duke pasur parasysh, ose në lidhje me ekzekutimin ose ekzekutimin e tentuar, ose ruajtjen apo ruajtjen e tentuar të çdo të drejte sipas, ose në përmbushjen e detyrave të tij sipas kësaj Marrëveshjeje dhe/ose një dokumenti tjetër financiar, duke përfshirë (në çdo rast) tarifat dhe shpenzimet e këshilltarëve ligjore dhe të tjerë. Secila bankë, me kërkesë, zhdëmton Agjentin (proporcionalisht në pajtim me shumat e dhëna dhe kontributet) ndaj detyrimeve, dëmeve, shpenzimeve dhe pretendimeve cilado qofshin që shkaktohen nga Agjenti në lidhje me këtë Marrëveshje dhe/ose një dokument tjetër financiar ose përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje dhe/ose një dokumenti tjetër financiar ose një veprim të kryer apo të mos kryer nga Agjenti sipas kësaj Marrëveshjeje dhe/ose një dokumenti tjetër financiar, përveç kur ky detyrim, dëmtim, shpenzim apo pretendim lindin nga neglizhenca e hapur ose sjellja e qëllimshme e Agjentit.

#### 16.13 Largimi nga detyra e Agjentit

16.13.1 Agjenti mund të largohet nga emërimi i tij si Agjent sipas kësaj Marrëveshjeje dhe dokumenteve të tjera financiare pasi t'i ketë dhënë Huamarrësit dhe secilës banke një njoftim tridhjetë (30)-ditor në lidhje me synimin e tij për të bërë këtë, me kusht që asnjë largim i tillë nuk hyn në fuqi, përveç kur emërohet nga bankat si agjent pasues:

- a) një bankë e emëruar nga bankat e shumicës ose, nëse nuk bëhet një emërim i tillë;
- b) një bankë me reputacion dhe me eksperiencë ose një institucion financiar me zyra në Londër të emëruar nga Agjenti.

Çdo korporatë në të cilën Agjenti mund të shkrihet ose konvertohet ose çdo korporatë me të cilën Agjenti mund të bashkohet ose çdo korporatë që rrjedh nga një shkrirje, konvertim, amalgamim, bashkim, ose riorganizim tjetër tek e cila Agjenti do të jetë palë, në masën e lejuar nga ligji i zbatuar, është Agjenti pasues në bazë të kësaj Marrëveshjeje dhe të dokumenteve të tjera financiare pa përfunduar ose dorëzuar ndonjë dokument ose ndonjë akt tjetër nga ana e palëve në këtë Marrëveshje ose në dokumentin financiar, përveç kur njoftimi për një shkrirje, konvertim, amalgamim, bashkim ose riorganizim tjetër i jepet menjëherë Huamarrësit dhe bankave.

16.13.2 Me emërimin e një pasuesi sa më sipër, Agjenti që largohet lirohet nga të gjitha detyrimet e tjera sipas kësaj Marrëveshjeje dhe dokumenteve të tjera financiare (por vazhdon të ketë përfitimin e kësaj klauzole 16 në lidhje me çdo veprim që ai ka marrë ose nuk ka marrë para këtij lirimi) dhe pasuesi i tij dhe secila prej palëve të tjera në këtë Marrëveshje do të ketë të njëjtat të drejta dhe detyrime ndërmjet tyre që do të kishin nëse ky pasues do të ishte palë në këtë Marrëveshje në vend të Agjentit që largohet. Agjenti që largohet i paraqet pasuesit të tij kopje të regjistrave të tij që pasuesit normalisht i duhen për të përmbushur funksionet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje dhe dokumenteve të tjera financiare.

#### 16.14 Ndryshimi i bankave të referencës

Nëse një bankë reference pushon së dhëni kuotimet Agjentit për qëllimet e caktimit të EURIBOR-it (nëse këto kuotime kërkohen duke pasur parasysh përkufizimin e EURIBOR-it në klauzolën 1.2), Agjenti, duke vepruar sipas udhëzimeve të bankave të shumicës, mund të prishë emërimin e kësaj banke reference dhe të emërojë një bankë tjetër për të zëvendësuar këtë bankë reference.

#### 17 Njoftimet për çështje të tjera

##### 17.1 Njoftimet

Çdo njoftim, kërkesë apo komunikim tjetër sipas kësaj Marrëveshjeje:

17.1.1 bëhet me shkrim dhe dorëzohet dorazi ose me letër të porositur të klasës së parë (postë ajrore, nëse ka);

17.1.2 konsiderohet të jetë marrë, duke respektuar parashikimet ndryshe të kësaj Marrëveshjeje, në rastin e një letre kur ajo dorëzohet dhe, në rastin e një telefaksi, kur nga i adresuari merret një kopje e plotë dhe e lexueshme (përveç kur data e dërgimit nuk është një ditë pune në vendin e të adresuarit ose momenti i dërgimit të një faksi është pas mbylljes së orarit zyrtar në vendin e të adresuarit dhe në këtë rast konsiderohet të jetë marrë në momentin e hapjes së orarit zyrtar të ditës tjetër të punës; dhe

##### 17.1.3 dërgohet:

a) nëse të Huamarrësi në:

(-)

(-)

Telefaks: (-)

Drejtuar: (-)

b) nëse tek Agjenti në:

Alpha Bank A.E., London Branch

66 Cannon Street

London EC4N 6EP

Telefaks: +44 207 236 1003

Drejtuar: Ms Rena Karagianni

c) nëse te rregulluesit në:

i) në rastin e Alpha Bank A.E. në:

Alpha Bank A.E.

40 Stadiou Street

102 52 Athens

Hellenic Republic

Telefaks: +30 210 326 4004

Drejtuar: Mr Yiannis Monastiriotis / Ms Maria Ioannidou

ii) në rastin e Bankës Kombëtare të Greqisë S.A. në:

(-)

(-)

(-)

d) nëse për një bankë, në adresën e saj ose numrin e telefaksit të përcaktuar në grafikun 1 ose në një certifikatë përkatëse zëvendësimi,

ose në një adresë tjetër ose numër telefaksi sipas njoftimit të palës përkatëse drejtuar palëve të tjera në këtë Marrëveshje.

17.2 Njoftimet nëpërmjet Agjentit

Çdo njoftim, kërkesë ose komunikim tjetër sipas kësaj Marrëveshjeje që jepet nga Huamarrësi për një palë tjetër i jepet Agjentit për t'u transmetuar rregullisht dhe për t'iu dhënë Huamarrësit (përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje) i jepet nga Agjenti.

17.3 Mungesa e heqjes dorë, mjetet kumulative

Mosushtrimi ose vonesa në ushtrimin nga ana e kreditorëve ose të ndonjërit prej tyre për të ushtruar një tagër, të drejtë ose mjet mbrojtjeje sipas kësaj Marrëveshjeje nuk është heqje dorë prej saj, dhe as ndonjë ushtrim i vetëm ose i pjesshëm nga kreditorët ose një prej tyre i një tagri, të drejte ose mjeti mbrojtës nuk përjashton të tjerët ose ushtrimin e mëtejshëm të tyre ose ushtrimin e ndonjë tagri, të drejte ose mjeti mbrojtës tjetër. Mjetet e mbrojtjes të parashikuara në këtë Marrëveshje janë kumulative dhe nuk janë përjashtuese për mjetet e para shikuara me ligj.

17.4 Përkthimet në anglisht

Të gjitha certifikatat, instrumentet dhe dokumentet e tjera që duhet të dorëzohen ose paraqiten në lidhje me këtë Marrëveshje janë në gjuhën angleze ose shoqërohen me një përkthim të certifikuar të përkthimit në anglisht tek i cili kreditorët kanë të drejtë të mbështeten.

17.5 Numri i kopjeve

Kjo Marrëveshje mund të përfundojë në çdo numër kopjesh dhe nga palë të ndryshme në kopje të ndryshme, secila prej të cilave kur përfundojë dhe dorëzohet në këtë mënyrë është një origjinal, por të gjitha kopjet së bashku përbëjnë të njëjtin instrument.

18 Ligji i zbatuar dhe juridiksioni

18.1 Ligji

Kjo Marrëveshje rregullohet dhe interpretohet në pajtim me ligjin anglez.

18.2 Nënshtrimi ndaj juridiksionit

Palët në këtë Marrëveshje bien dakord që:

18.2.1 nëse një palë ka një pretendim kundër një tjetre, që rrjedh nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje, ky pretendim i referohet Gjykatës së Lartë të Drejtësisë në Angli, juridiksionit të të cilës secila nga palët i nënshtrohet në mënyrë të përvokueshme; dhe

18.2.2 juridiksioni i Gjykatës së Lartë të Anglisë mbi secilën nga këto pretendime është juridiksion ekskluziv dhe asnjë gjykatë jashtë Anglisë nuk ka juridiksion për të shqyrtuar dhe vendosur për një pretendim të tillë;

18.3 Heqja dorë

Huamarrësi bie dakord që, me përjashtim të sendeve pasurore që rregullohen nga dispozitat e nenit 11 paragrafi 2 të Kushtetutës Shqiptare dhe dispozitat e ligjit shqiptar nr.8743, datë 22 shkurt 2001 “Mbi pasuritë e paluajtshme shqiptare” në lidhje me pasurinë publike dhe regjimin e saj pasuror: a) në çdo padi ose gjykim që rrjedh nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje kundër Huamarrësit ose një prej sendeve pasurore të tij, nuk pretendohet asnjë imunitet ndaj padisë ose gjykimit (që përfshin, pa kufizim, paditjen, sigurimin e padisë, garanci të tjera, marrjen e vendimit, ekzekutimin ose një zbatim tjetër) na ose në emër të Huamarrësit në lidhje me një prej sendeve pasurore të tij; b) heq dorë në mënyrë të pakthyeshme nga çdo e drejtë e tillë imuniteti që ai ose një prej sendeve pasurore të tij tashmë kanë ose mund të përftojnë më vonë ose që mund t’i vishet atij ose një prej sendeve pasurore të tij; dhe c) bie dakord përgjithësisht në lidhje me çdo padi ose gjykim të tillë për dhënien e mundësisë ose nxjerrjen e vendimit në lidhje me një padi ose vendim të tillë duke përfshirë, pa kufizim, përpilimin, zbatimin ose ekzekutimin kundër çdo pasurie (pavarësisht nga përdorimi i saj ose përdorimi i synuar) i një vendimi ose urdhri që mund të bëhet ose jepet në lidhje me këtë padi ose gjykim.

#### 18.4 Agjenti për dorëzimin e vendimit

Huamarrësi cakton, emëron ose autorizon në mënyrë të pakthyeshme (-) në prezencë të (-) të pranojë për të dhe në emër të tij dorëzimin e vendimit të nxjerrë nga gjykata e Lartë e Drejtësisë në Angli në lidhje me një pretendim që rrjedh prej ose në lidhje me këtë Marrëveshje.

#### 18.5 Akti i vitit 1999 për kontratat (të drejtat e palëve të treta)

Asnjë term i kësaj Marrëveshjeje nuk është i zbatueshëm në bazë të dispozitave të aktit të vitit 1999 për kontratat (të drejtat e palëve të treta) nga një person që nuk është palë në këtë Marrëveshje.

#### 18.6 Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi pas ekzekutimit nga palët dhe ratifikimit në Parlamentin e Shqipërisë.

Në dëshmi të kësaj, Palët në këtë Marrëveshje kanë realizuar përfundimin e rregullt të kësaj Marrëveshjeje në datën e shkruar më sipër.

### GRAFIKU 1 BANKAT DHE SHUMAT E DHËNA PREJ TYRE

Emri	Zyra huadhënëse dhe të dhënat e kontaktit	Shumat e dhëna (€)	
		Transhi A	Transhi B
Alpha Bank A.E., dega e Londrës	Zyra huadhënëse  66 Cannon Street London EC4N 6EP England  Adresa për njoftimet  Adresa: 66 Canon Street London EC4N 6EP England  Telefaks: +44 207 236 1003 Drejtuar: Ms Rena Karagianni	65 000 000	50 000 000

Emri	Zyra huadhënëse dhe të dhënat e kontaktit	Shumat e dhëna (€)	
		Transhi A	Transhi B
[Banka Kombëtare e Greqisë S.A., Dega e Londrës]	Zyra huadhënëse [•] [•] [•] [•] Adresa për njoftimet Adresa: [•] [•] [•] [•] Telefaks: +[•] Drejtuar: [•]	65 000 000	50 000 000
	Totali	130 000 000	100 000 000
	Shumat totale të dhëna	230 000 000 euro	

GRAFIKU 2  
FORMULARI I NJOFTIMIT TË TËRHEQJES

Drejtuar: Alpha Bank A.E.  
London Branch  
66 Cannon Street

London EC4N 6EP  
England

Drejtuar: [●]

{datë}

Programi €230,000,000

Marrëveshje huaje e datës [●] 2008

Ne i referohemi Marrëveshjes së mësipërme të huasë dhe u njoftojmë që ne duam të tërheqim një paradhënie të transhit [A] [B] në shumën €[●] në (datë) (dhe zgjedhim një periudhë të parë interesi për të prej [●] muajsh) (periudha e parë e interesit në lidhje me të skadon në (datë)). Fondet duhet të kreditohen në (emri dhe numri i llogarisë) me (të dhënat e bankës në (qytetin e Nju- Jorkut).

Ne konfirmojmë që:

i) nuk ka ndodhur apo vazhdon asnjë ngjarje ose rrethanë që përbën një mospërbushje;  
ii) përfaqësimet dhe garancitë që parashikohen në klauzolën 9.1 të Marrëveshjes së huasë (dhe kështu përfaqësimi dhe garancia e klauzolës 9.1.10 e Marrëveshjes së huasë i referohet për këtë qëllim pasqyrave të Huamarrësit në lidhje me vitin kalendarik që përfundon më 31 dhjetor (-)) janë të vërteta dhe të saktë në datën e këtij njoftimi si të jepej në lidhje me faktet dhe rrethanat që ekzistojnë në datën e këtij njoftimi;

iii) huamarrja që realizohet nëpërmjet kësaj paradhënieje do të jetë brenda tagreve tona, është autorizuar rregullisht me masa të përshtatshme dhe nuk do të përbëjë ndonjë tejkalim të ndonjë kufizimi mbi huamarrjen tonë (qoftë i caktuar me ligj, rregullore, marrëveshje apo ndryshe); dhe

iv) nuk ka pasur ndryshim material negativ në gjendjen tonë financiare ose në gjendjen financiare të Huamarrësit nga ajo që paraqitet në pasqyrat e përmendura në (ii) më sipër.

Fjalët dhe shprehjet e përkufizuara në këtë Marrëveshje huaje kanë të njëjtat kuptime nëse përdoren në këtë njoftim.

.....  
Për dhe në emër të:

Republikës së Shqipërisë (përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, duke vepruar nëpërmjet Ministrit të Financave)

GRAFIKU 3  
DOKUMENTE DHE PROVA QË KËRKOHEN SI PRECEDENT I KUSHTEVE

a) Të gjitha letrat e tarifave të përmendura në klauzolën 7.1, të përfunduara rregullisht nga Huamarrësi.

b) Një kopje të certifikuar, si një kopje e vërtetë, nga Ministri i Drejtësisë i Huamarrësit, e ligjit të Parlamentit të Shqipërisë të publikuar në Gazetën Zyrtare, që provon ratifikimin e dokumenteve të nënshkruara financiare pa ndryshime, bashkëngjitur opinionit të referuar në paragrafin (f).

c) Një kopje, të certifikuar, si një kopje e vërtetë nga një noter shqiptar, të autorizimit të Kryeministrit, të nënshkruar nga ky i fundit dhe gjithashtu nga Ministri i Punëve të Jashtme, që autorizon Ministrin e Financave të Huamarrësit për të përfunduar dhe dorëzuar dokumentet financiare dhe të bëjë të gjitha njoftimet dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet e kërkuara nga Huamarrësi sipas dokumenteve financiare.

d) Nëse Ministri i Financave ka autorizuar çdo person tjetër në vend të tij të ekzekutojë njoftimin e tërheqjes për llogari të Huamarrësit, një kopje e certifikuar e një prokure përkatëse të ekzekutuar nga Ministri i Financave të Huamarrësit (të noterizuar).

e) Një kopje të kontratës tregtare të datës 6 tetor 2006 ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, duke vepruar nëpërmjet Departamentit të Përgjithshëm të Rrugëve dhe Marrëveshjes së Përbashkët Bechtel-Enka, në lidhje me ndërtimin e seksionit Rrëshen-Kalimash të autostradës Durrës-Morinë.

f) Një mendim të Ministrit të Drejtësisë të Huamarrësit, të datës jo më parë se dyzet e pesë (45)

ditë bankare para datës së paradhënies së parë, në formë dhe përmbajtje në formularin e përcaktuar në grafikun 6 të bashkangjitur dhe vërtetuar si origjinal, një kopje të ligjit referuar në paragrafin (a) më sipër.

g) Në rast se Kalo&Associates, këshilltarëve të veçantë ligjorë në Shqipëri për bankat, këshillojnë bankat që mendimi i përmendur në “f” më sipër është në një aspekt i gabuar ose i pasaktë apo i pavlefshëm, atëherë një mendim të Kalo&Associates, në formë dhe përmbajtje në formularin e përcaktuar në grafikun 7, dhe, në rast se një nga mendimet sipas paragrafit “f” të këtij paragrafi “g” është i datës më parë se pesëmbëdhjetë (15) ditë bankare para datës së paradhënies së parë, një konfirmim të Kalo&Associates që ky mendim është akoma i vlefshëm dhe i përditësuar.

h) Një letër nga agjenti i Huamarrësit për pranimin e dorëzimit të vendimit të përmendur në klauzolën 18.4 që pranon emërimet e saj të caktuara.

#### GRAFIKU 4 LLOGARITJA E SHPENZIMEVE TË DETYRUESHME

1. Shpenzimet e detyrueshme janë shtesë mbi normën e interesit për të kompensuar bankat për shpenzimet e respektimit të: a) kërkesave të bankës së Anglisë dhe/ose Autoritetit të Shërbimeve Financiare (ose, në çdo rast, çdo autoritet tjetër që zëvendëson të gjithë ose një prej funksioneve të tij); ose b) kërkesat e Bankës Qendrore Europiane.

2. Në ditën e parë të çdo periudhe interesi (ose sa më parë të jetë e mundur pas kësaj) Agjenti llogarit, si një normë përqindjeje, një normë (normën shtesë të shpenzimeve) për secilën bankë për paradhënien përkatëse, në pajtim me paragrafët e përcaktuar në poshtë. Shpenzimi detyruar do të llogaritet nga Agjenti si një mesatare e ponderuar e normës shtesë të shpenzimeve të bankës (të ponderuar në raport me pjesëmarrjen në përqindje të çdo banke në paradhënien përkatëse ose shumën e papaguar) dhe do të shprehet si një normë përqindjeje në vit.

3. Norma shtesë e shpenzimeve për një bankë që jep hua nga një zyrë huadhënieje në një shtet anëtar pjesëmarrës do të jetë përqindja e njoftuar nga ajo bankë Agjentit. Kjo përqindje do të vërtetohet nga ajo bankë në njoftimin e saj për Agjentin të jetë një përcaktim i arsyeshëm i shpenzimeve (të shprehura si përqindje e pjesëmarrjes së asaj banke në paradhënien përkatëse ose shumën e papaguar të bërë nga ajo zyrë huadhënieje) për të përmbushur kërkesat minimale të rezervave të Bankës Qendrore Europiane në lidhje me huatë e dhëna nga ajo zyrë huadhënieje.

4. Norma shtesë e shpenzimeve për një bankë që jep hua nga një zyrë huadhënieje në Mbretërinë e Bashkuar do të llogaritet nga Agjenti si më poshtë:

$$\frac{E \times 0.01}{300} \text{ për qind në vit}$$

Ku “E” llogaritet për të kompensuar bankat për shumat e pagueshme sipas rregullave të tarifave dhe llogaritet nga Agjenti si të jetë mesatarja e normave më të fundit të tarifave të dhëna nga bankat e referencës Agjentit në pajtim me paragrafin 6 më poshtë dhe shprehet në paundë £1,000,000.

5. Për qëllimin e këtij grafiku:

a) “Rregulla të tarifave” janë rregullat për tarifat periodike që parashikohen në manualin e mbikëqyrjes FSA ose në një ligj apo rregullore tjetër që mund të jetë në fuqi herë pas here në lidhje me pagesën e tarifave për pranimin e depozitave;

b) “Tarifa mbi tarifat” janë tarifat mbi tarifat e përcaktuara në rregullat e tarifave brenda grupit aktivitetit A.1 të pranuesve të depozitave (duke mos marrë parasysh asnjë tarifë minimale ose tarifë zero që kërkohet në pajtim me rregullat e tarifave por duke marrë parasysh çdo normë skontoje të zbatueshme);

c) “Depozitat e veçanta” ka kuptimin që i jepet herë pas here në bazë të ose në pajtim me Aktin e Bankës së Anglisë 1998 (sipas rastit) nga Banka e Anglisë; dhe

d) “Baza e tarifave” ka kuptimin që i është dhënë dhe llogaritet në pajtim me rregullat e tarifave.

6. Nëse kërkohet nga Agjenti, çdo bankë reference, sa më shpejt që të jetë praktike pas publikimit nga Autoriteti i Shërbimeve Financiare, i paraqet Agjentit normën e tarifës të pagueshme nga ajo bankë reference për Autoritetin e Shërbimeve Financiare në pajtim me rregullat e tarifave në lidhje

me vitin përkatës financiar të Autoritetit të Shërbimeve Financiare (të llogaritur për këtë qëllim nga banka e referencës të jetë mesatarja e tarifave mbi tarifën e zbatueshme për atë bankë reference për atë vit financiar) dhe të shprehur në paundë për £1,000,000 të bazës së tarifës të bankës së referencës.

7. Secila bankë jep atë informacion që kërkohet nga Agjenti për qëllimin e llogaritjes së normës shtesë të shpenzimeve. Veçanërisht, pa kufizim, çdo bankë paraqet informacionin e mëposhtëm në ose para datës në të cilën ajo bëhet një bankë:

a) juridiksionin e zyrës së saj të huadhënies; dhe

b) çdo informacion tjetër që Agjencia mund të kërkojë të mënyrë të arsyeshme për këtë qëllim.

Secila bankë njofton menjëherë Agjentin për çdo ndryshim në lidhje me informacionin e dhënë prej saj në pajtim me këtë paragraf.

8. Normat e tarifave të secilës bankë reference për qëllimin e “E” sa më sipër përcaktohet nga Agjenti bazuar në informacionin e dhënë në pajtim me paragrafët 6 dhe 7 të mësipërm dhe me prezumimin që, përveç kur një bankë njofton Agjentin për të kundërtën, të gjitha detyrimet e çdo banke në lidhje me depozitat e raportit të parave dhe depozitave të veçanta janë të njëjta si ato të një banke tipike nga juridiksioni i saj i themelimit me një zyrë huadhënieje në të njëjtin juridiksion si zyrat e saj huadhënieje.

9. Agjenti nuk ka detyrim ndaj asnjë personi nëse ky përcaktim rezulton në një normë shtesë të shpenzimeve që mbi ose nënkompenson një bankë dhe ka të drejtë të prezumojë që informacioni i dhënë nga një bankë ose bankë reference në pajtim me paragrafët 3, 6 dhe 7 të mësipërm është i vërtetë dhe i saktë në të gjitha aspektet.

10. Agjenti shpërndan shumat shtesë të marra si rezultat i shpenzimeve të detyrueshme tek bankat mbi bazën e normës së shpenzimeve shtesë për secilën bankë të bazuar në informacionin e dhënë nga secila bankë dhe secila bankë reference në pajtim me paragrafët 3, 6 dhe 7 më sipër.

11. Çdo përcaktim nga Agjenti në pajtim me këtë grafik në lidhje me një formulë, shpenzimet e detyrueshme, normën e shpenzimeve shtesë ose çdo shumë që i paguhet një banke, në mungesë të gabimit të dukshëm, është përfundimtare dhe detyruese për të gjitha palët në Marrëveshje.

12. Agjenti, herë pas here, pas konsultimeve me Huamarrësin dhe bankat, mund të përcaktojë dhe njoftojë të gjitha palët në këtë Marrëveshje për çdo ndryshim që kërkohet të bëhet në këtë grafik me qëllim që të përmbushë një ndryshim në ligj, rregullore ose kërkesat e caktuara herë pas here nga banka e Anglisë, Autoriteti i Shërbimeve Financiare ose Banka Qendrore Europiane (ose sipas rastit, çdo autoritet tjetër që zëvendëson të gjitha ose një në të gjithë funksionet) dhe çdo përcaktim i tillë, në mungesë të gabimit të dukshëm, është përfundimtar dhe detyrues për të gjitha palët në Marrëveshje.

## GRAFIKU 5 FORMULARI I CERTIFIKATËS SË ZËVENDËSIMIT

Bankat këshillohen të mos përdorin certifikata zëvendësimi pa u siguruar së pari që ky veprim juridik është në pajtim me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme, duke përfshirë aktin e shërbimeve financiare dhe tregjeve 2000 dhe rregulloret e bëra në zbatim të tij.

Drejtuar: (emri dhe adresa)

Në vëmendje të:

{datë}

Certifikatë zëvendësimi

Kjo certifikatë zëvendësimi ka të bëjë me një marrëveshje (Marrëveshje) e datës (datë 2007) ndërmjet: 1. Republikës së Shqipërisë (që vepron nëpërmjet Ministrisë së Financave), si Huamarrës; 2. Alpha Bank A.E. dhe Bankës Kombëtare të Greqisë S.A si rregullues; 3. bankave, emrat e tyre përkatës dhe adresat janë përcaktuar në grafikun 1 të saj si “bankat”; dhe 4. Alpha Bank A.E. Dega e Londrës si Agjenti. Termat e përkufizuara në Marrëveshje kanë të njëjtin kuptim në këtë certifikatë zëvendësimi.

1. (Emri i bankës ekzistuese) (banka ekzistuese): a) konfirmon saktësinë e kësaj përmbledhjeje të shumave të dhëna dhe kontributeve të përcaktuara në grafikun e kësaj certifikate zëvendësimi; dhe b) i kërkon (emri i bankës zëvendësuese) (Zëvendësuesi) për të pranuar nëpërmjet zëvendësimit pjesën e shumave të dhëna dhe kontributit të saj të përcaktuar në grafikun e kësaj certifikate zëvendësimi, duke sigluar dhe dorëzuar këtë certifikatë zëvendësimi tek Agjenti në adresën e tij për dorëzimin e njoftimeve të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

2. Zëvendësuesi i kërkon Agjentit (në emër të vet, Huamarrësit dhe bankave) të pranojë këtë certifikatë zëvendësimi sikur i dorëzohet Agjentit në pajtim me dhe për qëllimet e klauzolës 15.3 të Marrëveshjes, në mënyrë që të hyjë në fuqi në pajtim me termat e saj në (data e transferimit), (duke mos qenë më parë se (5) ditë bankare pas datës së dorëzimit të kësaj certifikate zëvendësimi tek Agjenti) (data e hyrjes në fuqi).

3. Agjenti (në emër të vet dhe të palëve të tjera në këtë Marrëveshje) konfirmon zëvendësimin e realizuar nga certifikata e zëvendësimit në pajtim me dhe për qëllimet e klauzolës 15.3 të Marrëveshjes.

Zëvendësuesi konfirmon:

a) që ai ka marrë një kopje të Marrëveshjes dhe të gjithë dokumentacionin dhe informacionin e kërkuar prej tij në lidhje me transaksionet e parashikuara nga kjo certifikatë zëvendësimi;

b) që ai ka bërë vlerësimin e tij për përfundimin, efektivitetin, përshtatshmërinë, vërtetësinë, vlefshmërinë, ekzekutueshmërinë dhe pranueshmërinë faktike të Marrëveshjes, të dokumenteve të tjerë financiarë dhe të kësaj certifikate zëvendësimi dhe nuk është mbështetur dhe nuk do të mbështetet mbi bankën ekzistuese ose pasqyrat e bëra nga banka ekzistuese në këtë aspekt;

c) që ai ka bërë dhe do të vazhdojë të bëjë vlerësimin e vet për aftësinë për kredimarrje të Huamarrësit dhe të gjitha subjekteve qeveritare dhe hetimin e vet të pavarur të gjendjes financiare, prospekteve dhe çështjeve të Huamarrësit dhe subjekteve qeveritare dhe nuk është mbështetur dhe nuk do të mbështetet tek banka ekzistuese ose ndonjë pasqyrë, opinion, parashikim ose përfaqësim tjetër të bërë nga banka ekzistuese; dhe

d) përkatësisht, banka ekzistuese nuk ka detyrim ose përgjegjësi ndaj zëvendësuesit në lidhje me ndonjë nga çështjet e mësipërme.

5. Përfundimi i kësaj certifikate zëvendësimi nga zëvendësuesi përbën përfaqësimin e tij ndaj bankës ekzistuese dhe të gjitha palëve në këtë Marrëveshje dhe ai ka tagrin të bëhet palë në Marrëveshje si Bankë me termat e saj dhe të përcaktuara atje dhe ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të autorizuar përfundimin dhe dorëzimin e kësaj certifikate zëvendësimi.

6. Zëvendësuesi pranon që banka ekzistuese nuk ka detyrim për të riblerë ose ripërftuar ndonjë prej të drejtave dhe detyrimeve të zëvendësuar nëpërmjet kësaj certifikate zëvendësimi ose për të mbështetur, zhdëmtuar ose kompensuar zëvendësuesin për çdo humbje të pësuar nga zëvendësuesi si pasojë e zëvendësimit të realizuar nëpërmjet kësaj certifikate zëvendësimi.

7. Zëvendësuesi merr përsipër para bankës ekzistuese, Huamarrësit dhe Agjentit që ai do të përmbushë në pajtim me termat e tyre të gjitha detyrimet që në bazë të termave të Marrëveshjes do të merren përsipër prej tij pas pranimit të kësaj certifikate zëvendësimi nga Agjenti.

8. Kjo certifikatë zëvendësimi rregullohet nga ligji anglez.

Shënim. Kjo certifikatë zëvendësimi nuk është letër me vlerë, bono, letër borxhi apo një instrument i ngjashëm.

Si dëshmi, nënshkrimet e firmatarëve të autorizuar të palëve në atë datë janë më poshtë.

#### GRAFIKU

Shuma e kontributit (€)	Data(t) pasuese për pagesën e interesit	Pjesa e kaluar (€)

Shuma e kontributit (€)		Pjesa e kaluar (€)

TË DHËNA ADMINISTRATIVE PËR ZËVENDËSUESIN

Zyra huadhënëse:  
Llogaria për pagesat:  
Telefon:  
Telefaks:  
Drejtuar:

[Banka ekzistuese]	[Zëvendësuesi]
Nga:	Nga:
Datë:	Datë:
Agjenti	
Nga:	

Në emër të vet  
Dhe në emër të Huamarrësit dhe palëve të tjera ne Marrëveshje

Datë:

GRAFIKU 6  
FORMULARI I MENDIMIT TË MINISTRIT TË DREJTËSISË TË HUAMARRËSIT

Private & konfidenciale I

Drejtuar: Alpha Bank A.E., London Branch  
66 Cannon Street  
London EC4N 6EP  
England  
(si Agjent)

[•] 2007

Të dashur zotërinj!

Huaja prej 230 000 000 euro për Republikën e Shqipërisë (të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, që vepron nëpërmjet Ministrit të Financave).

1. Ne i referohemi marrëveshjes (Marrëveshja) e datës (-) korrik 2007 e lidhur ndërmjet: i) Republikës së Shqipërisë (të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, që vepron nëpërmjet Ministrit të tij të Financave) si huamarrës (Huamarrësi); ii) Alpha Bank A.E. dhe Bankës Kombëtare të Greqisë S.A. si rregullues (rregulluesit); iii) bankave dhe institucioneve financiare të renditura në grafikun 1 të Marrëveshjes si huadhënëse (bankat); dhe iv) juve si agentë për bankat (Agjenti) dhe së bashku me rregulluesin dhe bankat, (kreditorët), në lidhje me huanë e përshkruar më sipër, në lidhje me të cilën ne kemi vepruar si këshilltarët tuaj të veçantë ligjorë në Shqipëri.

Shprehjet e përkufizuara në Marrëveshje kanë të njëjtët kuptime kur përdoren në këtë opinion.

2. Ne kemi shqyrtuar origjinalet ose kopjet e certifikuara të bindur për dokumentet e mëposhtme:

- Marrëveshjen;
- Dy (2) letrat për tarifën të datës (-) 2007 (secila një “letër për tarifën” dhe së bashku “letrat për tarifën” dhe, së bashku me Marrëveshjen, “dokumentet financiare”), të bëra përkatësisht ndërmjet Huamarrësit dhe Agjentëve dhe Huamarrësit, Agjentit dhe rregulluesve;
- Ligjin e Parlamentit të Shqipërisë të publikuar në Fletoren Zyrtare, nr. (-) që vërteton ratifikimin e dokumenteve financiare të nënshkuara pa ndryshime;
- (Aprovimin për hyrjen në dokumentet financiare të të cilat Huamarrësi është palë nga (-) Huamarrësi; dhe)
- (Dokumente të tjera specifike që renditen; dhe)
- Një kopje të certifikuar, si një kopje autentike nga një noter shqiptar, të autorizimit të

Kryeministrit, të nënshkruar nga ky i fundit dhe nga Ministri i Punëve të Jashtme, që autorizon Ministrin e Financave dhe Huamarrësin për të përfunduar dhe dorëzuar dokumentet financiare dhe për të bërë të gjitha njoftimet dhe të ndërmarrë të gjithë veprimet e tjera që kërkohen nga Huamarrësi sipas dokumenteve financiare; dhe

g) Ekzemplarë të nënshkrimeve, të vërtetuara nga një noter shqiptar, të Ministrit të Financave të personit të autorizuar në ligjin e Parlamentit të përmendur në paragrafin “c” të mësipërm.

Ne kemi bërë edhe hetime të tjera dhe shqyrtuar dokumente të tjera, që i kemi konsideruar të përshtatshme për qëllimin e dhënies së mendimit të caktuar më sipër.

3. Për qëllimet e këtij mendimi, ne kemi prezumuar:

a) që Marrëveshja dhe çdo letër për tarifën është autorizuar, përfunduar dhe dorëzuar rregullisht nga secila prej palëve të ndryshëm nga Huamarrësi; dhe

b) autenticitetin e të gjitha firmave në të gjitha dokumentet dhe plotësinë, dhe përputhshmërinë me dokumentet origjinale të të gjitha kopjeve që na janë dhënë.

4. Ne jemi të mendimit të mëposhtëm:

a) Huamarrësi ka kompetencën për të përfunduar, dorëzuar dhe përmbushur detyrimet sipas dokumenteve financiare dhe të marrë shumat totale të dhëna; janë marrë të gjitha masat e duhura për të autorizuar përfundimin, dorëzimin dhe përmbushjen e dokumenteve financiare dhe asnjë kufizim i kompetencave të tij për të marrë hua nuk do të tejkalohet si rezultat i huamarrjeve sipas Marrëveshjes.

b) Ministri i Financave të Huamarrësit, duke vepruar në emër të Këshillit të Ministrave të Huamarrësit, ka kompetencë dhe autoritetin e plotë dhe të pakushtëzuar të Huamarrësit për të marrë përsipër dokumentet financiare në emër të Huamarrësit dhe të ketë besimin dhe kredinë e plotë të Huamarrësit për përmbushjen e duhur nga Huamarrësi të detyrimeve të tij sipas dokumenteve financiare.

c) Marrëveshja dhe dokumentet e tjera financiare përbëjnë detyrimet e vlefshme dhe ligjrisht të detyrueshme për Huamarrësin të ekzekutueshme në pajtim me kushtet e tyre përkatëse.

d) Detyrimet e Huamarrësit, sipas dokumenteve financiare, janë detyrime të drejtëpërdrejta, të përgjithshme dhe të pakushtëzuara të Huamarrësit dhe renditen të paktën njëllor me të gjitha detyrimet e tjera të tashme dhe të ardhshme të pasiguruara dhe primare të Huamarrësit me përjashtim të ndonjë detyrimi që është ligjrisht i preferueshëm dhe jo me kontratë.

e) Detyrimet e Huamarrësit, sipas dokumenteve financiare, janë detyrime jo të drejtëpërdrejta dhe të pakushtëzuara të Huamarrësit dhe renditen të paktën njëllor me të gjitha detyrimet e tjera të tashme dhe të ardhshme të pasiguruara dhe primare të Huamarrësit me përjashtim të ndonjë detyrimi që është ligjrisht i preferueshëm dhe jo me kontratë.

f) Përfundimi dhe dorëzimi i, marrja e shumave totale të dhëna dhe përmbushja e detyrimeve sipas, dhe respektimi i dispozitave të dokumenteve financiare nga Huamarrësi: i) nuk bie në kundërshtim me Kushtetutën shqiptare ose ndonjë ligj, statut, rregull ose rregullore ekzistuese, ose ndonjë vendim, dekret ose leje që i nënshtrohet; ii) nuk bie në kundërshtim me, si rezultat i një shkeljeje të ndonjë kushti të, ose nuk përbën një mospërmbushje sipas një traktati bilateral ose multilateral ose marrëveshje ose instrumenti tjetër tek e cila është palë ose që i nënshtrohet, ose që i nënshtrohet një pronë e tij; ose iii) nuk rezulton në krijimin, caktimin ose e detyron Huamarrësin të krijojë një rëndim barësor mbi një ndërmarrje, send pasuror, të drejta ose të ardhura të Huamarrësit.

g) Çdo pëlqim, autorizim, licencë ose aprovim i, ose regjistrim apo deklarim tek organet qeveritare ose publike apo autoritete ose gjykata të kërkuara për të autorizuar, ose të kërkuara nga Huamarrësi në lidhje me përfundimin, dorëzimin, vlefshmërinë, ekzekutueshmërinë ose pranueshmërinë në prova të dokumenteve financiare ose përmbushja e detyrimeve sipas çdo dokumenti financiar ose përmbushje e detyrimeve sipas çdo detyrimi financiar është përftuar ose marrë dhe është në fuqi dhe me efekt të plotë dhe nuk ka qenë me vonesë në përmbushjen e kushteve ose kufizimeve (sipas rastit) të caktuara në, ose në lidhje me, çdonjërin.

h) Nuk është e nevojshme të sigurohet vlefshmëria, ligjshmëria, ekzekutueshmëria ose pranueshmëria në prova e asnjë dokumenti financiar që ai ose një instrument tjetër të noterizohet, dorëzohet, regjistrohet, shënohet ose futet në asnjë gjykatë, zyrë publike apo gjetkë në Shqipëri ose një vulë, regjistrim ose taksë e ngjashme apo tarifë të paguhet në Shqipëri në lidhje me dokumentet financiare (përveç ndonjë tarife/pagesave për legalizimin që duhet të paguhet për përkthimin e këtyre dokumenteve në gjuhën shqipe nga një përkthyes i autorizuar, sipas rastit) dhe çdo dokument financiar është në formë të përshtatshme për ekzekutimin e tij në gjykatat e Shqipërisë.

i) Asnjë gjykim, arbitrazh, procedurë administrative nuk po zhvillohet, nuk është në gjykim e

sipër, ose, sipas njohurive të mia pas hetimeve të përshtatshme, të filluar kundër Huamarrësit që mund të ketë një efekt negativ material mbi aftësinë e Huamarrësit për të përmbushur detyrimet e tij sipas çdo dokumenti financiar.

j) Huamarrësi nuk është (dhe nuk do të ishte, pas dhënies së njoftimit ose parashkrimit ose përmbushjes së një prej kushteve të tjera ose një kombinimi të tyre) në shkelje ose vonesë sipas një marrëveshjeje në lidhje me qenien në borxh tek e cila është palë ose tek e cila mund të detyrohet dhe asnjë mospërmbushje tjetër nuk ka ndodhur dhe nuk po vazhdon.

k) Huamarrësi është një anëtar në një gjendje të mirë i Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe asnjë kufizim nuk është vendosur në përdorimin prej tij të burimeve të ndonjërit prej këtyre institucioneve për mospërmbushjen e detyrimeve të tij si një anëtar i njërit prej këtyre institucioneve.

l) Zgjedhja nga Huamarrësi e ligjit anglez për të rregulluar dokumentet financiare është një zgjedhje e vlefshme e ligjit dhe ligji anglez do të zbatohet përkatësisht nga gjykatat e Shqipërisë nëse një prej dokumenteve financiare ose një pretendim sipas tij futet në juridiksionin e tyre, duke pasur si provë dispozitat përkatëse të ligjit anglez. Nënshtrimi nga Huamarrësi ndaj juridiksionit joekskluziv të gjykatave angleze dhe emërimi i parevokueshëm nga Huamarrësi i një agjenti në Angli për të pranuar dorëzimin e kërkesave në lidhje me juridiksionin e këtyre gjykatave janë të vlefshme dhe detyruese për Huamarrësin.

m) Me përjashtim e sendeve pasurore, të përfshihen brenda dispozitave të nenit 11 paragrafi 2 të Kushtetutës Shqiptare dhe sipas dispozitave të ligjit shqiptar nr.8743, datë 22 shkurt 2001 “Mbi pasuritë e paluajtshme shtetërore” në lidhje me pasuritë publike dhe regjimin e tyre ligjor:

i) Huamarrësi i nënshtrohet ligjit civil dhe tregtar në lidhje me detyrimet e saj sipas dokumenteve financiare;

ii) çdo huamarrje nga Huamarrësi sipas Marrëveshjes dhe përfundimi dhe dorëzimi dhe përmbushja e detyrimeve të tij sipas dokumenteve financiare nga Huamarrësi përbëjnë akte private dhe tregtare të bëra për qëllime private dhe tregtare; dhe

iii) as Huamarrësi dhe asnjë prej sendeve të tij pasurore nuk ka të drejtën e imunitetit për shkak të sovranitetit ose ndryshe nga një padi ose gjykim (që përfshin, pa kufizim, paditjen, sigurimin e padisë para vendimit, ekzekutimin ose zbatim tjetër) dhe një heqje dorë e parashikuar në klauzolën 18.3 të Marrëveshjes nga Huamarrësi, për çdo të drejtë të tillë imuniteti është detyruese e parevokueshme për Huamarrësin.

n) Nuk është vendosur asnjë taksë duke e mbajtur apo në formë tjetër, për asnjë pagesë të bërë nga Huamarrësi sipas dokumenteve financiare ose që vendoset apo nëpërmjet përfundimit apo dorëzimit nga Huamarrësi të një prej dokumenteve financiare ose një dokument apo instrument që përfundohet ose dorëzohet sipas dokumenteve financiare ose ndonjë prej tyre.

o) Gjykatat e Shqipërisë do të japin një vendim në lidhje me dokumentet financiare ose një prej tyre të shprehur në euro në lidhje me çdo shumë të kërkueshme ose të marrë hua kreditorëve ose ndonjërit prej tyre sipas dokumenteve financiare ose ndonjërit prej tyre, nëse këtë e kërkojnë kreditorët, dhe/ose do të pranojë si vendim të vlefshëm dhe ekzekutojë çdo vendim përfundimtar, përmbyllës ose të ekzekutueshëm të kërkuar nga kreditorët ose një prej tyre kundër Huamarrësit në një gjykatë angleze.

p) Asnjë prej kreditorëve nuk është ose nuk do të mendohet të jetë me vendbanim, qëndrim, të zhvillojë biznes ose t’u nënshtrohet tatimeve në Shqipëri për shkak të vetëm negocimit, përgatitjes, përfundimit, përmbushjes, ekzekutimit të ose marrjes së çdo pagese të kërkueshme nga Huamarrësi, sipas dokumenteve financiare ose një prej tyre; dhe

q) Nuk është e nevojshme sipas ligjeve të Shqipërisë: i) me qëllim që t’u mundësohet kreditorëve ose njërit prej tyre të ekzekutojnë të drejtat e tyre sipas dokumenteve financiare ose një prej tyre; ose ii) për shkak të përfundimit, dorëzimit ose përmbushjes së dokumenteve financiare ose të një prej tyre nga kreditorët ose një prej tyre, që kreditorët ose një prej tyre duhet të licencohen, kualifikohen ose përndryshe të kenë të drejtë të zhvillojnë biznes në Shqipëri.

5. Ky mendim është i kufizuar për çështjet ligjore të Shqipërisë. Ne nuk shprehim mendim në lidhje me ligjin e ndonjë juridiksioni tjetër.

6. Ky mendim ju drejtohet juve si një Agjent për bankat dhe mund të besohet nga Norton Rose si avokatët tuaj dhe kreditorët e tjerë sikur t’u drejtohej secilës prej këtyre palëve individualisht.

Sinqerisht juaji

GRAFIKU 7  
FORMULARI I MENDIMIT TË KËSHILLTARIT TË VEÇANTË LIGJOR I BANKËS SË  
SHQIPËRISË

[Koka e letrës për këshilltarët e veçantë ligjorë]

Private & konfidenciale 1

Drejtuar: Alpha Bank A.E., London Branch  
66 Cannon Street  
London EC4N 6EP  
England  
(si Agjent)

[•] 2007

Të dashur zotërinj

Huaja prej 230 000 000 euro për Republikën e Shqipërisë (të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, që vepron nëpërmjet Ministrit të Financave).

1. Ne i referohemi marrëveshjes (Marrëveshja) e datës (-) korrik 2007 e lidhur ndërmjet: i) Republikës së Shqipërisë (të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, që vepron nëpërmjet Ministrit të tij të Financave) si huamarrës (Huamarrësi); ii) Alpha Bank A.E. dhe Bankës Kombëtare të Greqisë S.A. si rregullues (Rregulluesit); iii) bankave dhe institucioneve financiare të renditura në grafikun 1 të Marrëveshjes si huadhënës (bankat); dhe iv) juve si agjentë për bankat ("Agjenti" dhe së bashku me rregulluesin dhe bankat, "kreditorët"), në lidhje me huanë e përshkruar më sipër, në lidhje me të cilën ne kemi vepruar si këshilltarët tuaj të veçantë ligjorë në Shqipëri. Shprehjet e përkufizuara në Marrëveshje kanë të njëjtët kuptime kur përdoren në këtë mendim.

2. Ne kemi shqyrtuar origjinalet ose kopjet e certifikuara të bindur për dokumentet e mëposhtme:

a) Marrëveshjen;

b) Dy (2) letrat për tarifën të datës (-) 2007 (secila një "letër për tarifën" dhe së bashku "letrat për tarifën" dhe, së bashku me Marrëveshjen, "dokumentet financiare") të bëra përkatësisht ndërmjet Huamarrësit dhe Agjentëve dhe Huamarrësit, Agjentit dhe rregulluesve;

c) Ligjin e Parlamentit të Shqipërisë të publikuar në Fletoren Zyrtare, nr. (-) që vërteton ratifikimin e dokumenteve financiare të nënshkuara pa ndryshime;

d) (Aprovimin për hyrjen në dokumentet financiare të cilat Huamarrësi është palë nga (-) Huamarrësi; dhe)

e) (dokumente të tjera specifike që renditen; dhe)

f) Një kopje të certifikuar, si një kopje autentike nga një noter shqiptar, të autorizimit të Kryeministrit, të nënshkuar nga ky i fundit dhe nga Ministri i Punëve të Jashtme, që autorizon Ministrin e Financave dhe Huamarrësin për të përfunduar dhe dorëzuar dokumentet financiare dhe për të bërë të gjitha njoftimet dhe të ndërmarrë të gjithë veprimet e tjerë që kërkohen nga Huamarrësi sipas dokumenteve financiare; dhe

g) Ekzemplarë të nënshkrimeve, të vërtetuara nga një noter shqiptar, të Ministrit të Financave të personit të autorizuar në ligjin e Parlamentit të përmendur në paragrafin "c" të mësipërm.

Ne kemi bërë edhe hetime të tjera dhe shqyrtuar dokumente të tjerë, që i kemi konsideruar të përshtatshme për qëllimin e dhënies së mendimit të caktuar më sipër.

3. Për qëllimet e këtij mendimi, ne kemi prezumuar:

a) që Marrëveshja dhe çdo letër për tarifën është autorizuar, përfunduar dhe dorëzuar rregullisht nga secila prej palëve në të të ndryshëm nga Huamarrësi; dhe

b) autenticitetin e të gjitha firmave në të gjithë dokumentet dhe autenticitetin dhe plotësinë e të gjitha dokumenteve që na janë dhënë dhe përputhshmërinë me dokumentet origjinale, të të gjitha kopjeve që na janë dhënë si kopje të certifikuara, të njësuara, fotostatike, elektronike ose faksi.

4. Ne jemi të mendimit të mëposhtëm:

a) Huamarrësi ka kompetencën për të përfunduar, dorëzuar dhe përmbushur detyrimet sipas dokumenteve financiare dhe të marrë shumat totale të dhëna; janë marrë të gjitha masat e duhura për të autorizuar përfundimin, dorëzimin dhe përmbushjen e dokumenteve financiare dhe asnjë kufizim i

kompetencave të tij për të marrë hua nuk do të tejkalohet si rezultat i huamarrjeve sipas Marrëveshjes.

b) Ministri i Financave të Huamarrësit, duke vepruar në emër të Këshillit të Ministrave të Huamarrësit, ka kompetencë dhe autoritetin e plotë dhe të pakushtëzuar të Huamarrësit për të marrë përsipër dokumentet financiare në emër të Huamarrësit dhe të ketë besimin dhe kredinë e plotë të Huamarrësit për përmbushjen e duhur nga Huamarrësi të detyrimeve të tij sipas dokumenteve financiare.

c) Marrëveshja dhe dokumentet e tjera financiare përbëjnë detyrimet e vlefshme dhe ligjrisht të detyrueshme për Huamarrësin të ekzekutueshëm në pajtim me kushtet e tyre përkatëse.

d) Detyrimet e Huamarrësit, sipas dokumenteve financiare, janë detyrime të drejtpërdrejta, të përgjithshme dhe të pakushtëzuara të Huamarrësit dhe renditen të paktën njëllor me të gjitha detyrimet e tjera të tashme dhe të ardhshme të pasiguruara dhe primare të Huamarrësit me përjashtim të ndonjë detyrimi që është ligjrisht i preferueshëm dhe jo me kontratë.

e) Detyrimet e Huamarrësit, sipas dokumenteve financiare, janë detyrime jo të drejtpërdrejta dhe të pakushtëzuara të Huamarrësit dhe renditen të paktën njëllor me të gjitha detyrimet e tjera të tashme dhe të ardhshme të pasiguruara dhe primare të Huamarrësit, me përjashtim të ndonjë detyrimi që është ligjrisht i preferueshëm dhe jo me kontratë.

f) Përfundimi dhe dorëzimi i, marrja e shumave totale të dhëna dhe përmbushja e detyrimeve sipas, dhe respektimi i dispozitave të dokumenteve financiare nga Huamarrësi:

i) nuk bie në kundërshtim me Kushtetutën shqiptare ose ndonjë ligj të zbatueshëm;

ii) sipas të gjitha dijenive tona:

1. nuk bie në kundërshtim me ndonjë statut, rregull ose rregullore ekzistuese, ose ndonjë vendim, dekret ose leje që i nënshtrohet;

2. nuk bie në kundërshtim me, si rezultat i një shkeljeje të ndonjë kushti të, ose nuk përbën një mospërmbushje sipas një traktati bilateral ose multilateral ose marrëveshje ose instrumenti tjetër tek e cila është palë ose që i nënshtrohet, ose që i nënshtrohet një pronë e tij; ose

3. nuk rezulton në krijimin, caktimin ose e detyron Huamarrësin të krijojë një rëndim barësor mbi një ndërmarrje, send pasuror, të drejta ose të ardhura të Huamarrësit.

g) Çdo pëlqim, autorizim, licencë ose aprovim i, ose regjistrim apo deklaram tek organet qeveritare ose publike apo autoritete ose gjykata të kërkuara për të autorizuar, ose të kërkuara nga Huamarrësi në lidhje me përfundimin, dorëzimin, vlefshmërinë, ekzekutueshmërinë ose pranueshmërinë në prova të dokumenteve financiare ose përmbushja e detyrimeve sipas çdo dokumenti financiar ose përmbushje e detyrimeve sipas çdo detyrimi financiar është përftuar ose marrë dhe është në fuqi dhe me efekt të plotë dhe nuk ka qenë në vonesë në përmbushjen e kushteve ose kufizimeve (sipas rastit) të caktuara në, ose në lidhje me çdonjërin;

h) Nuk është e nevojshme të sigurohet vlefshmëria, ligjshmëria, ekzekutueshmëria ose pranueshmëria në prova e asnjë dokumenti financiar që ai ose një instrument tjetër të noterizohet, dorëzohet, regjistrohet, shënohet ose futet në asnjë gjykatë, zyrë publike apo gjetkë në Shqipëri ose një vulë, regjistrim ose taksë e ngjashme apo tarifë të paguhet në Shqipëri në lidhje me dokumentet financiare (përveç ndonjë tarife/pagesave për legalizimin që duhet të paguhet për përkthimin e këtyre dokumenteve në gjuhën shqipe nga një përkthyes i autorizuar, sipas rastit) dhe çdo dokument financiar është në formë të përshtatshme për ekzekutimin e tij në gjykatat e Shqipërisë.

i) Sipas gjithë njohurive tona, Huamarrësi është një anëtar në një gjendje të mirë i Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe asnjë kufizim nuk është vendosur në përdorimin prej tij të burimeve të ndonjërit prej këtyre institucioneve për mospërmbushjen e detyrimeve të tij si një anëtar i njërit prej këtyre institucioneve.

j) Zgjedhja nga Huamarrësi e ligjit anglez për të rregulluar dokumentet financiare është një zgjedhje e vlefshme e ligjit dhe ligji anglez do të zbatohet përkatësisht nga gjykatat e Shqipërisë nëse një prej dokumenteve financiare ose një pretendim sipas tij futet në juridiksionin e tyre duke pasur si provë dispozitat përkatëse të ligjit anglez. Nënshtrimi nga Huamarrësi ndaj juridiksionit joekskluziv të gjykatave angleze dhe emërimi i parevokueshëm nga Huamarrësi i një agjenti në Angli për të pranuar dorëzimin e kërkesave në lidhje me juridiksionin e këtyre gjykatave janë të vlefshme dhe detyruese për Huamarrësin.

k) Me përjashtim e sendeve pasurore, të përfshihen brenda dispozitave të nenit 11 paragrafi 2 të Kushtetutës Shqiptare dhe sipas dispozitave të ligjit shqiptar nr.8743, datë 22 shkurt 2001 “Mbi pasuritë

e paluajtshme shtetërore” në lidhje me pasuritë publike dhe regjimin e tyre ligjor:

- Huamarrësi i nënshtrohet ligjit civil dhe tregtar në lidhje me detyrimet e saj sipas dokumenteve financiare;

- çdo huamarrje nga Huamarrësi sipas Marrëveshjes dhe përfundimi dhe dorëzimi dhe përmbushja e detyrimeve të tij sipas dokumenteve financiare nga Huamarrësi përbëjnë akte private dhe tregtare të bëra për qëllime private dhe tregtare; dhe

- as Huamarrësi dhe asnjë prej sendeve të tij pasurore nuk ka të drejtën e imunitetit për shkak të sovranitetit ose ndryshe nga një padi ose gjykim (që përfshin, pa kufizim, paditjen, sigurimin e padisë para vendimit, ekzekutimin ose zbatim tjetër) dhe një heqje dorë e parashikuar në klauzolën 18.3 të Marrëveshjes nga Huamarrësi, për çdo të drejtë të tillë imuniteti është detyruese e parevokueshme për Huamarrësin.

l) Nuk është vendosur asnjë taksë duke e mbajtur apo në formë tjetër, për asnjë pagesë të bërë nga Huamarrësi sipas dokumenteve financiare ose që vendoset apo nëpërmjet përfundimit apo dorëzimit nga Huamarrësi të një prej dokumenteve financiare ose një dokument apo instrument që përfundohet ose dorëzohet sipas dokumenteve financiare ose ndonjë prej tyre.

m) Gjykatat e Shqipërisë do të japin një vendim në lidhje me dokumentet financiare ose një prej tyre të shprehur në euro në lidhje me çdo shumë të kërkueshme ose të marrë hua kreditorëve ose ndonjërit prej tyre sipas dokumenteve financiare ose ndonjërit prej tyre, nëse këtë e kërkojnë kreditorët, dhe/ose do të pranojë si vendim të vlefshëm dhe ekzekutojë çdo vendim përfundimtar, përmbyllës ose të ekzekutueshëm të kërkuar nga Kreditorët ose një prej tyre kundër Huamarrësit në një gjykatë angleze.

n) Asnjë prej kreditorëve nuk është ose nuk do të mendohet të jetë me vendbanim, qëndrim, të zhvillojë biznes ose t’u nënshtrohet tatimeve në Shqipëri për shkak të vetëm negocimit, përgatitjes, përfundimit, përmbushjes, ekzekutimit të ose marrjes së çdo pagese të kërkueshme nga Huamarrësi, sipas dokumenteve financiare ose një prej tyre; dhe

o) Nuk është e nevojshme sipas ligjeve të Shqipërisë: i) me qëllim që t’u mundësohet kreditorëve ose njërit prej tyre të ekzekutojnë të drejtat e tyre sipas dokumenteve financiare ose një prej tyre; ose ii) për shkak të përfundimit, dorëzimit ose përmbushjes së dokumenteve financiare ose të një prej tyre nga kreditorët ose një prej tyre, që kreditorët ose një prej tyre duhet të licencohen, kualifikohen ose përndryshe të kenë të drejtë të zhvillojnë biznes në Shqipëri.

5. Ne jemi të kualifikuar të praktikojmë ligjin në Shqipëri. Ne nuk jemi të kualifikuar të japim mendime në lidhje me ligjet e një juridiksioni tjetër dhe nuk kemi bërë hetim të pavarur në ligjet e Anglisë ose ndonjë juridiksioni tjetër se ligjet në fuqi në Shqipëri si një bazë për mendimet e shprehura këtu. Ne nuk shprehim asnjë mendim në lidhje me ligjin e ndonjë juridiksioni tjetër.

6. Ky mendim jepet prej nesh për ju në datën e këtushme dhe ne nuk shprehim mendim në lidhje me lëndën e këtushme për ndonjë datë tjetër dhe ne nuk marrim përsipër t’ju këshillojmë juve për ndodhinë e ndonjë ngjarjeje ose rrethane pas datës së këtushme që mund të ndikojë në mendimin e shprehur këtu.

7. Ky mendim, ju drejtohet ju si Agjent i bankave dhe mund të merret i mirëqenë nga Norton Rose si avokati tuaj dhe kreditorët e tjerë sikur t’u drejtohej secilës prej këtyre palëve individualisht.

Sinqerisht i juaji,  
[KALO & ASSOCIATES]

\*

Nga \_\_\_\_\_

NËNSHKRUAR nga )  
dhe nga )  
për dhe në emër të ) .....  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ) Nënshkrues i (të) autorizuar  
(përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, )  
duke vepruar nëpërmjet Ministrit të Financave) )  
si Huamarrës )

NËNSHKRUAR nga ) .....  
dhe nga ) Nënshkrues i autorizuar  
për dhe në emër të )  
ALPHA BANK A.E. ) .....  
si rregullues ) Nënshkrues i autorizuar

NËNSHKRUAR nga ) .....  
dhe nga ) Nënshkrues i autorizuar  
për dhe në emër të )  
BANKA KOMBËTARE E GREQISË S.A. ) .....  
si rregullues ) Nënshkrues i autorizuar

NËNSHKRUAR nga ) .....  
dhe nga ) Nënshkrues i autorizuar  
për dhe në emër të )  
ALPHA BANK A.E., LONDON BRANCH ) .....  
si Agjent ) Nënshkrues i autorizuar

NËNSHKRUAR nga ) .....  
dhe nga ) Nënshkrues i autorizuar  
për dhe në emër të )  
ALPHA BANK A.E., LONDON BRANCH ) .....  
si bankë ) Nënshkrues i autorizuar

NËNSHKRUAR nga ) .....  
dhe nga ) Nënshkrues i autorizuar  
për dhe në emër të )  
BANKA KOMBËTARE E GREQISË S.A., )  
DEGA E LONDRËS ) .....  
si Bankë ) Nënshkrues i autorizuar

Drejtuar: Republikës së Shqipërisë  
Ministrit të Financave

Të dashur Zotërinj

Letër për tarifën

1. Kjo letër është shtesë e marrëveshjes së huasë datë (-) 2008 (Marrëveshja) e përfunduar ndërmjet: (i) Republikës së Shqipërisë (përfaqësuar nga Këshilli i saj i Ministrave, që vepron nëpërmjet Ministrit të tij të Financave) si Huamarrës (Huamarrësi). ii) Alpha Bank A.E. dhe Bankës Kombëtare të Greqisë S.A. si rregullues (në këtë cilësi “Rregulluesit” dhe “Rregulluesi” është secili prej tyre). iii) bankat dhe institucionet financiare të përmendura në grafikun 1 të saj si Huadhënës (së bashku “Bankat”); dhe iv) Alpha Bank A.E, si Agjent (në këtë cilësi “Agjent”), në pajtim me të cilën Bankat kanë rënë dakord (nëpërmjet të tjerash) t’i japin në formën e huasë Huamarrësit, me termat dhe kushtet që përmbahen atje, shumën principale deri në dyqind e tridhjetë milionë euro (230,000,000). Kjo letër është letra e agjencisë e përmendur në klauzolën 7.1.2 të Marrëveshjes.

2. Fjalët dhe shprehjet e përkufizuara në marrëveshje, nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe ose nëse nuk përkufizohen ndryshe në të, kanë të njëjtin kuptim sikur përdoren në këtë letër.

3. Huamarrësi i paguan Agjentit një tarifë agjencie prej tridhjetë mijë euro (30,000 €) në vit në datën e parë të tërheqjes dhe në çdo përvjetor të tij deri sa të jenë paguar plotësisht të gjitha mjetet financiare të marra hua në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

Kjo tarifë është tarifë e agjencisë, e përmendur në klauzolën 7.1.2 të Marrëveshjes dhe është e pakthyeshme.

4. Mospërputhja nga ana juaj plotësisht e kushteve të kësaj letre përbën një rast mospërbushjeje sipas Marrëveshjes.

5. Jeni të lutur të konfirmoni përlqimin tuaj për sa më sipas duke kundërsigluar dhe kthyer tek ne kopjen e bashkëngjitur të kësaj letre.

6. Letra rregullohet dhe interpretohet në pajtim me ligjin anglez.

Sinqerisht i juaji

Nënshkruar nga:

Për dhe në emër të

Alpha Bank A.E.

si Agjent

Datë 2008

Ne konfirmojmë marrjen e kësaj letre dhe biem dakord plotësisht me termat dhe kushtet e përcaktuara më sipër

Nënshkruar nga:

Për dhe në emër të Republikës së Shqipërisë

(përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave

që vepron nëpërmjet Ministrit të tij të Financave

si Huamarrës

Datë 2008

Drejtuar: Republikës së Shqipërisë  
Ministrit të Financave

Të dashur Zotërinj

Letër për tarifën

1. Kjo letër është shtesë e marrëveshjes së huasë datë (-) 2008 (Marrëveshja) e përfunduar ndërmjet (i) Republikës së Shqipërisë (përfaqësuar nga Këshilli i saj i Ministrave, që vepron nëpërmjet Ministrit të tij të Financave) si Huamarrës (Huamarrësi), ii) Alpha Bank A.E. dhe Bankës Kombëtare të Greqisë S.A. si rregullues (në këtë cilësi “Rregulluesit” dhe “Rregulluesi” është secili prej tyre), iii) bankat dhe institucionet financiare të përmendura në grafikun 1 të saj si Huadhënës (së bashku “Bankat”); dhe iv) Alpha Bank A.E, si Agjent (në këtë cilësi “Agjent”), në pajtim me të cilën Bankat kanë rënë dakord (nëpërmjet të tjerash) t’i japin në formën e huasë Huamarrësit, me termat dhe kushtet që përmbahen atje, shumën principale deri në dyqind e tridhjetë milionë euro (230,000,000). Kjo letër është letra e tarifës së rregullimit e përmendur në klauzolën 7.1.1 të Marrëveshjes.

2. Fjalët dhe shprehjet e përkufizuara në marrëveshje, nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe ose nëse nuk përkufizohen ndryshe në të, kanë të njëjtin kuptim sikur përdoren në këtë letër.

3. Huamarrësi do t’i paguajë Agjentit, për llogari të Rregulluesve (dhe për ndarje dhe shpërndarje ndërmjet Rregulluesve dhe Bankave në raporte të tilla si është rënë dakord individualisht ndërmjet tyre), një tarifë rregullimi prej dy milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë mijë euro (2,760,000 €), që do të paguhet në datën e parë të tërheqjes.

Kjo tarifë është tarifë e rregullimit, e përmendur në klauzolën 7.1.1 të Marrëveshjes dhe është e pakthyeshme.

4. Mospërputhja nga ana juaj plotësisht e kushteve të kësaj letre përbën një rast mospërmbushjeje sipas Marrëveshjes.

5. Jeni të lutur të konfirmoni përlqimin tuaj për sa më sipas duke kundërsigluar dhe kthyer tek ne kopjen e bashkëngjitur të kësaj letre.

6. Letra rregullohet dhe interpretohet në pajtim me ligjin anglez.

Sinqerisht i juaji

Nënshkruar nga:

Për dhe në emër të

Alpha Bank A.E.

si Agjent dhe Rregullues

Datë 2008

Nënshkruar nga:

Për dhe në emër të

Banka Kombëtare e Greqisë S.A

Si Rregullues

Datë 2008

Ne konfirmojmë marrjen e kësaj letre dhe biem dakord plotësisht me termat dhe kushtet e përcaktuara më sipër

Nënshkruar nga:

Për dhe në emër të Republikës së Shqipërisë

(përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave

që vepron nëpërmjet Ministrisë së Financave)  
si Huamarrës  
Datë 2008

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)**  
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.  
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 16.5.2008  
Doli nga shtypi më 16.5.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Ilar”  
Tiranë, 2008

Çmimi 44 lekë